



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 22/2019 regjistër (JR)
Datë 02.05.2019

Nr. 16 i vendimit
Datë 13.07.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 13.07.2020, ditën e hënë, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hysni Demiraj, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 108, datë 15.02.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 179, pikat 2, 3 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet A, C, D, Dh, E dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; nenet 62, 63, 65 e vijues, neni 66/1/b i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nenet 47 e 49/2 e vijues.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkesat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 108, datë 15.02.2019

të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hysni Demiraj, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të të dhënave të tjera të përcjella prej agjencive ligjzbatuese, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kritereve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.

1.3 KLD-ja, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Hysni Demiraj, ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të cilin ia ka përcjellë Komisionit³, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 16.04.2018.

Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 108, datë 15.02.2019.

¹ Raporti i ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 08.01.2018,

² Raporti i DSIK-së nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. 86, datë 28.03.2018.

³ Raporti i KLD-së nr. {***} prot., datë 16.04.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni, me vendimin nr.108, datë 15.02.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, si më poshtë.

2.1 Për kriterin e kontrollit të pasurisë:

- i. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për sa i përket vlerës së paguar për m², për blerjen e pasurisë apartament banimi, përshkruar si pasuria 1.*
- ii. Ka mospërputhje midis deklaramit të bërë në deklaratën "vetting" dhe në deklaratën për vitin 2013, për pasurinë garazh, me sip. 29,2 m², me deklaramin e bërë në vitin 2010, me sip. 15 m².*
- iii. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për blerjen e pasurisë garazh, pasi ka deklaruar nga viti 2010 deri në vitin 2012 shumën 12.500 euro, ndërsa në vitin 2013 ka deklaruar shumën 8.000 euro.*
- iv. Subjekti është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e pasurive, në raport me shtetas/blerës të tjerë, pasi është provuar ekzistenca e konfliktit të tij të interesit në gjykimin i një çështjeje civile dhe, për pasojë, edhe marrëdhëniet kontraktuale të blerjes së pasurive çmohen fiktive.*
- v. Personi tjetër i lidhur i subjektit të rivlerësimit, shtetasi P. K., nuk justifikon me burime të ligjshme huan e dhënë në shumën prej 5.000.000 lekësh.*
- vi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve të huas në shumën prej 5.000.000 lekësh, vit pas viti.*
- vii. Vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk justifikon me burime të ligjshme huan e dhënë në shumën 30.000 euro.*
- viii. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e parë të shumës 2.000 euro, nga huaja e marrë në shumën 30.000 euro, nga personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, në vitin 2013.*
- ix. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë për blerjen e automjetit në vitin 2004, zhdoganuar në vitin 2005.*
- x. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e gjendjes cash (500.000 lekë) në fund të vitit 2004, për shlyerjen e shumës 503.000 lekë, në shkurt 2005, shumë të cilën subjekti e ka deklaruar se përfaqëson zhdoganimin dhe rregullime të tjera të automjetit.*

2.2 Për kontrollin e figurës, Komisioni ka konkluduar se nuk janë gjetur elemente që të tregojnë për subjektin e rivlerësimit për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës.

2.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton se ka mangësi që lidhen me kontrollin e kriterit të aftësive profesionale që konstatohen nga analiza e kryer për disa çështje gjyqësore të përmendura në vendim, si edhe se është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit për sa i përket pjesëmarrjes në trupën gjyqësore që ka gjykuar çështjen gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 08.02.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*
 - *rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale si edhe nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit, më datë 16.04.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 108, datë 15.02.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar⁴ nga Komisioni me vendimin nr. 108/4, datë 26.04.2019.
5. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të shqyrtojë çështjen duke e gjykuar atë në seancë gjyqësore publike, duke marrë dhe provat e reja të paraqitura me ankimin e të çmojë të gjitha provat e tjera dhe procesin, me qëllimin për t'i garantuar atij të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me të gjitha provat dhe në përfundim të vendosë për ndryshimin e vendimit nr. 108, datë 15.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj dhe konfirmimin e tij në detyrë.
6. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit Hysni Demiraj ndaj vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, si shkaqe të ankimit janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

A. Mbi procesin e rregullt ligjor, si dhe vlerësimi i shkaqeve me natyrë procedurale

6.1 Në vendimin e Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, si dhe në procedurën e zhvilluar gjatë hetimit administrativ, janë cenuar një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: parimi i arsytimit të vendimit; parimi i aksesit; parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; parimi i mosdiskriminimit; parimi i pavarësisë dhe paanësisë; parimi i shtetit të së drejtës; parimi i ligjshmërisë; parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve; parimi i zbatimit të ligjit në kohë dhe hapësirë (ligji nuk ka fuqi prapavepruese).

6.2 Procedura e zhvilluar gjatë fazës së hetimit administrativ është e parregullt dhe në vendimin e Komisionit ka gabime materiale dhe shtrembërim të fakteve.

6.3 Analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi një analizë ligjore të provave të paraqitura dhe as çmuarjen ligjore të tyre; duke passjellë që, lidhur me pasurinë, të

⁴ *Fillimisht Komisioni me vendimin e tij nr. 108/2, datë 17.04.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se nuk plotëson kërkesat e nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", pasi numri i kopjeve të akteve bashkëlidhur ankimit nuk ishte i plotë. Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 26.04.2019, ka bërë pranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit Hysni Demiraj, pasi prej tij u paraqitën aktet e ankimit në 3 (tri) kopje të njësuara me origjinalin të protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 23.04.2019.*

keqinterpretohet ligji kushtetues (neni D i Aneksit të Kushtetutës) dhe ligji organik (neni 61, pikat 1 e 3 të ligjit nr. 84/2016).

B. Shkaqe që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë

6.4 Subjekti në ankim pretendon se konkluzioni i vendimit të Komisionit se nuk është deklaruar saktë çmimi për metër katror i apartamentit në {***}, Tiranë, nuk është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht, pasi referuar kontratës së sipërmarrjes dhe asaj për kalimin e pronësisë, rezulton se vlera e pasurisë ka mbetur e njëjtë.

a) Për sa i përket pasurisë garazh, konkluzioni i vendimit se ka mospërputhje midis deklarimit të sipërfaqes së kësaj pasurie në deklaratën *vetting* me sipërfaqen e deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, si edhe konkluzioni se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, pasi ka deklaruar nga viti 2010 deri në vitin 2012 shumën 12.500 euro, ndërsa në vitin 2013 ka deklaruar shumën 8.000 euro, nuk janë të drejtë dhe të bazuar ligjërisht.

b) Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial nga shoqëria {***} ShPK, për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë, është i paargumentuar dhe i pabazuar ligjërisht.

6.5 Nuk janë të drejta dhe të bazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit në drejtim të huadhënësit P. K., pasi ai ka pasur likuiditete në dispozicion si dhe burime të ligjshme disa herë më të mëdha se shumata e dhënë hua, prej 50.000 eurosh, konkluzione që tregojnë se Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme provat e paraqitura.

6.6 Analiza financiare e kryer nga Komisioni nuk është e saktë, pasi subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas vit pas viti dhe se nuk qëndron konstatimi për mospërputhje në deklarin e vitit 2013.

6.7 Është i pabazuar në prova konkluzioni i vendimit se vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk provon se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës prej 30.000 eurosh, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

6.8 Nuk qëndron konstatimi i Komisionit lidhur me automjetin e blerë në vitin 2004, të cilin e ka përfshirë pa të drejtë në analizën financiare të vitit 2004. Analiza e kryer nuk ka konsideruar shpjegimet e subjektit se vlera e deklaruar në deklaratën periodike për automjetin, përfaqëson jo vetëm çmimin e blerjes, por edhe detyrimet doganore dhe riparimet e tij.

C. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

6.9 Raporti i vlerësimit të KLD-së për kontrollin e aftësitë profesionale është i padrejtë, pasi në të nuk janë konsideruar vlerësimet që ky organ ka bërë ndër vite, ecuria e karrierës së subjektit të rivlerësimit, moscenimi i vendimeve të tij nga shkallët e tjera të gjyqësorit, zbardhja në kohë e vendimeve etj.

6.10 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë gjykimit të çështjes nr. {***}, datë 08.02.2013, me palë të paditur M. dhe V. D., nuk është i argumentuar dhe i bazuar ligjërisht.

6.11 Analiza e kryer nga Komisioni për denoncimin e shtetasit A. M. është tërësisht në kundërshtim me ligjin, e njëanshme dhe bashkëpunuese me denoncuesin.

6.12 Denoncimi në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2011, që i përket masës së sigurisë ndaj shtetasit S. Ç., është dezinformues, keqdashës, shumë i pabazuar e i bërë me qëllimin e vetëm për të politizuar subjektin e rivlerësimit me pohime të rreme.

6.13 Analizimi i denoncimit të shtetasit A. M. për vendimin civil nr. {***}, datë 08.04.2014, që i përket çështjes së likuidatores A. K., përveçse është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi kjo çështje është ende në gjykim në Gjykatën e Lartë, por Komisioni për këtë çështje në mënyrë të qëllimshme ka paraqitur fakte të pavërteta dhe ka bërë një analizë joligjore të provave.

6.14 Analizimi i denoncimit për çështjen që i përket të pandehurit F. Sh., për të cilin Gjykata e Apelit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 19.11.2015, përveçse është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi kjo çështje është ende në gjykim, ka të bëjë thjesht me një “lajthitje në objekt”, e cila nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për palët.

6.15 Nuk janë të drejta, të vërteta dhe të argumentuara çështjet e ngritura në denoncimin e shtetasit M. B., lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 03.11.2017.

6.16 Në çështjen për të cilën nga Gjykata e Apelit Tiranë është dhënë vendimi nr. {***}, datë 27.02.2018, me palë të paditur denoncuesin B. Sh., është zbatuar me përpikëri ligji dhe se gabimet materiale të vërejtura mbi procedurat për heqin dorë të gjyqtarëve janë gabime njerëzore, pa pasoja dhe të riparueshme.

Ç. Shkaqe që lidhen me cenimin e besimit të publikut

6.17 Nuk është i drejtë dhe i argumentuar qëndrimi i Komisionit se është cenuar besimi i publikut, pasi një gjë e tillë nuk rezultoi e provuar gjatë hetimit të kontrollit të aftësive profesionale; pjesë e këtij vlerësimi të bërë prej Komisionit nuk duhet të ishin denoncimet e individit A. M. pasi ato janë të padrejta, por duhet të ishte vlerësuar formimi i subjektit, rezultatet në testim dhe ecuria e karrierës.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, u mor në shqyrtim në Kolegj në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012 i ndryshuar”).

7.1 Me ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim debatimin e provave në prani të tij, në funksion të ndreqjes së shkeljeve të rënda procedurale e të konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë të plotë e të saktë, sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, si edhe shqyrtimin e provave të reja të paraqitura bashkëlidhur ankimit.

7.2 Në shqyrtimin e këtij pretendimi të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se subjekti ka depozituar bashkëlidhur ankimit disa akte⁵ në cilësinë e provave të reja.

7.3 Kolegji konstaton se kryesisht këto akte (që janë kontratat e shitblerjes së pasurive në objektet e ndërtuara nga kompania {***} ShPK) gjendeshin të administruara në fashikujt e provave të administruara nga Komisioni dhe, për pasojë, informacioni i sjellë prej tyre është i administruar tashmë prej Komisionit dhe nuk përmban elemente të reja për t'u trajtuar prej Kolegjit. Në këtë këndvështrim, aktet e sjella prej subjektit bashkëlidhur ankimit, nuk plotësojnë elementet e një prove të re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

7.4 Përveç këtyre konstatimeve, Kolegji shqyrtoi gjithashtu edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të gjykuar këtë çështje në seancë gjyqësore publike, por në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentua ndonjë shkelje procedurale apo konstatim i gabuar i situatës faktike në kuptim të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor për shërimin e tyre, siç subjekti pretendon.

7.5 Në këto rrethana, Kolegji çmoi se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, prandaj vendosi që gjykimi të zhvillohej në dhomë këshillimi konform përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te zbatimi i nenit 49 i ligjit nr. 49/2012.

B. Shqyrtimi i shkaqeve që lidhem me procesin e rregullt ligjor

8. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se me vendimin e Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, janë cenuar: (i) parimi i arsytimit të vendimit; (ii) parimi i aksesit; (iii) parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; (iv) parimi i mosdiskriminimit; (v) parimi pavarësisë dhe paanësisë; (vi) parimi i shtetit të së drejtës; (vii) parimi i ligjshmërisë; (viii) parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve; (ix) parimi i zbatimit të ligjit në kohë dhe hapësirë (ligji nuk ka fuqi prapavepruese) – Kolegji konstaton se pretendimet e subjektit që lidhen me cenimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor për shkak të shkeljeve të pretenduara si më lart, nuk janë të bashkëlidhura ndaj ndonjë shkeljeje konkrete që pretendohet të ketë ndodhur gjatë hetimit

⁵ Aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit janë:

- 1 Vërtetim nr. {***} rep., datë 08.04.2019, për njësimin e njësisë me origjinalin e kontratave të shitblerjeve të apartamenteve dhe garazheve të ndërtuara nga kompania “{***}” ShPK në rrugën e “{***}”, të cilat janë: kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 30.08.2013; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 29.07.2013; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 16.02.2013; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.12.2017; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 04.12.2017; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 07.11.2016; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 09.10.2013; kontratë me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 25.10.2013.
- 2 Informacion i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***} prot., datë 15.04.2019, në lidhje me sistemin audio dhe raportet e gjeneruara RDA sipas gjyqtarëve për vitet 2013-2016, me praktikë bashkëlidhur, mbi komunikime me e-mail ndër vite që lidhen me këto raporte.
- 3 Vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {***} rep., datë 12.04.2019, i notares L. M., për dokumentin: Deklaratë verbale dhënë prej R. D. e A. M. në prani të A.B.
- 4 Dokument bankar të datës 17.04.2009, titulluar “Kërkesë për transfertë fondesh vetëm brenda bankës” me vlerës 2.200.000 lekë, me urdhërues D. B. dhe përfitues A. M.

administrativ në Komision. Subjekti nuk ka identifikuar në ankimin e tij asnjë problematikë apo rrethanë, e cila do të përbënte shkak për Kolegjin që të verifikonte nëse kishte ndodhur apo jo në shkelje të parimeve të pretenduara prej subjektit. Në vlerësimin e Kolegjit, vetëm pretendimi i shkeljes së parimeve të procesit të rregullt sepse ka pasur një vendimmarrje të kontestueshme dhe në dëm të interesave të tij, nuk është element i mjaftueshëm për të legjitimuar analizën mbi këto pretendime, të cilat duhet të lidhen patjetër me qëndrime konkrete apo veprime konkrete procedurale që pretendohen se janë kryer në shkelje të ligjit dhe që kanë sjellë si pasojë shkeljen e parimeve të procesit të rregullt, duke përbërë në këtë mënyrë një bazë të rëndësishme për cenimin e procesit të zhvilluar për këto arsye.

8.1 Nga shqyrtimi në tërësi i akteve procedurale të ndodhura në fashikullin e krijuar nga Komisioni për procesin e rivlerësimit të subjektit Hysni Demiraj, konstatohet se trupa e Komisionit ka pasur me të komunikim të vazhdueshëm që në momentin fillestar të hetimit, i cili ka vijuar deri në mbyllje të tij. Rezulton se subjekti ka marrë dijeni të plotë lidhur me konkluzionet paraprake të hetimit të Komisionit, si dhe i është dhënë e drejta për të dhënë shpjegime si gjatë hetimit, por edhe pas njohjes së rezultateve paraprake të hetimit. Referuar akteve, konstatohet se subjekti gjatë hetimit e me shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit dhe në seancë, ka paraqitur prova të cilat janë shqyrtuar e vlerësuar nga Komisioni, siç ka ndodhur edhe me kërkesën e subjektit për të thirrur dëshmitarë, të cilën e ka refuzuar me vendim të trupit gjykues, tek i cili ka parashtruar arsyet e këtij refuzimi, fakte që gjejnë pasqyrim edhe në arsyetimin e vendimit të marrë prej Komisionit⁶.

8.2 Nga një analizim i përgjithshëm i pretendimeve të ngritura në ankim për këtë shkak ankimi, vihet re se subjekti më së shumti parashtron se vlerësimi i provave të sjella prej tij ka qenë i njëanshëm dhe jo i drejtë. Ky qëndrim mbahet prej subjektit në ato raste kur provat e sjella prej tij nuk janë çmuar/konsideruar nga trupi gjykues, se ato provojnë faktin për të cilin janë paraqitur. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se fakti që Komisioni ka marrë qëndrime për çështje të caktuara mbi argumentin se subjekti nuk ka mundur të provojë me provat e paraqitura që ka një nivel të pranueshëm për kriteret e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, dëshmon në vetvete se provat e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi në përputhje me bindjen e brendshme të trupës në Komision. Fakti që ky vlerësim i provave nga Komisioni është i ndryshëm nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se ka munguar vlerësimi i tyre, por tregon se provat e sjella pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij nuk kanë mundur të provojnë faktin për të cilin janë paraqitur dhe ky vlerësim në çmim të Kolegjit konsiderohet si një pushtet diskrecional i Komisionit, në përputhje me atributet gjyquese e vlerësuese që ky organ ka në këtë proces, sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016

Gjithashtu, referuar të dhënave të vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, por edhe akteve të administruara në fashikull, në kuptim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, për subjektin e rivlerësimit Komisioni ka zhvilluar seancë dëgjimore publike, tek e cila pas relatimit të komisionerit relator, subjekti ka dhënë shpjegime e ka parashtruar pretendimet e tij për të kundërshtuar rezultatet dhe gjetjet e hetimit administrativ, në ushtrim të së drejtës së tij për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar.

8.3 Në këto kushte, Kolegji konstaton se jo vetëm që subjekti nuk ka ngritur ndonjë pretendim të ri lidhur me ndonjë shkelje konkrete të procesit të rregullt të kryer në Komision, por edhe nga analiza e shqyrtimi i veprimtarisë procedurale të kryer nga Komisioni, nuk u gjenden

⁶ Referuar paragrafit nr. 36.29 të vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019.

elemente të kësaj veprimtarie, që do të konsideroheshin se janë kryer në shkelje të parimeve të procesit të rregullt, për pasojë arrihet në konkluzionin se Komisioni ka respektuar gjatë procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të gjitha garancitë që ofrohen nga zbatimi i parimeve të pretenduara si të shkelura prej tij e që konsistojnë në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 6 të KEDNj-së.

9. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se procedura e zhvilluar gjatë fazës së hetimit administrativ është e parregullt; dhe se në vendimin e Komisionit ka gabime materiale dhe shtrembërim të fakteve.

9.1 Në ankimin lidhur me këtë shkak, subjekti parashtron se në seancë dëgjimore provat e paraqitura prej tij vetëm sa janë përmendur shkarazi dhe nuk është debatuar mbi to; në arsyetimin e vendimit nuk debatohet asnjë nga këto prova dhe shtrembërohen faktet e vendimeve të formës së prerë dhe keqinterpretohet me dashje Kodi i Procedurës Civile e Kodi i Procedurës Penale, si dhe ligjet organike. Subjekti parashtron se është hedhur poshtë kërkesa e tij për të paraqitur dëshmitarë dhe se akti shkresor që pretendohet se ka në përmbajtje atë informacion që do të vinte nga dëshmia, nuk është analizuar. Subjekti shpreh rezerva lidhur me seancën dëgjimore, për të cilën pretendon se nuk ka përmbushur qëllimin e saj, që është njohja dhe diskutimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të arritura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe ngre pretendimin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, ka gabime materiale dhe shtrembërim të fakteve të provuara në dosje, të cilat lidhen me raportin e DSIK-së.

9.2 Lidhur me këto parashtrime të ngritura në ankim nga subjekti, konstatohet se prej tij pasaktësitë e konstatuara në vendim, ndahen në dy kategori: në *gabime materiale*, ku përfshin referimin e gabuar në tekstin e vendimit të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore publike; dhe në *gabime "me dashje"*, të bëra si pasojë e shtrembërimit të fakteve të provuara në dosje, të cilat subjekti përfshin të dhënat e paragrafit 16 të vendimit nr. 108, datë 15.02.2019, të Komisionit, tek i cili është shprehur: *Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar me vendimin të KDZH-së nr. {***} prot., datë 28.03.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Demiraj.*

9.3 Lidhur me sa është pasqyruar në paragrafin 16 të vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, referuar akteve të administruara në fashikull, konstatohet se raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj e konsideron atë të përshtatshëm për vijimin e detyrës. Në analizë të vendimit të Komisionit, konstatohet se kjo pasaktësi është bërë në pjesën hyrëse të vendimit, ku referohen raportet e strukturave ndihmëse, si: ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo KLD-ja, të mbledhura nga Komisioni. Ky raport i DSIK-së, në mënyrë të plotë gjendet i analizuar në pjesën arsyetuese të vendimit dhe konkretisht në pjesën B, paragrafi 42 i tij, ku jepen dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me kontrollin e figurës, duke konkluduar se nuk janë gjetur elemente që të tregojnë për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës. Ky konkluzion i Komisionit mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Hysni Demiraj, tregon se deklarimi në pjesën hyrëse të vendimit, se raporti i DSIK-së e ka klasifikuar si të papërshtatshëm, është thjesht një gabim material.

9.4 Në vijim të sa më sipër, konstatohet se Komisioni me vendimin nr. 108/3, datë 19.04.2019, ka kryer korrigjimin e gabimeve materiale të vendimit të tij nr. 108, datë 15.02.2019, të cilin ia ka njoftuar respektivisht subjektit, Komisionerit Publik, ONM-së dhe Kolegjit të

Posaçëm të Apelimit më datë 23.04.2019. Me anë të këtij vendimi, Komisioni ka ndrequr gabimet materiale të referuara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, duke saktësuar se: “[...] Në fund të pikës "16", në togfjalëshin "... në përfundim të të cilit ka konstatuar, *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Q. Demiraj*, gabimisht është shkruar fjala "*papërshtatshmërinë*", ndërsa duhej shkruar "*përshtatshmërinë*", si dhe në Seksionin II "SEANCA DËGJIMORE", në pikën "23", gabimisht është shkruar togfjalëshi "... më datë 23.07.2018, ora 9:00, ...", ndërsa duhej shkruar "... më datë 13.02. 2019, ora 12:00, ...”.

9.5 Duke analizuar faktet e mësipërme në raport me pretendimin e parashtruar në ankim, Kolegji çmon së pari se të dyja rrethanat e pretenduara prej subjektit se kanë përbërë gabime të Komisionit, lidhen me dy gabime materiale të Komisionit, të cilat kanë ardhur si pasojë e gabimeve në shkrim të vendimit të arsyetuar. Këto rrethana nuk përfaqësojnë situatat faktike të vërteta të cilat ka trajtuar Komisioni, qoftë konkluzioni i DSIK-së për papërshtatshmërinë, qoftë vendosja e një dite të gabuar lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore. Komisioni ka trajtuar në vendimin e tij dhe për më tepër ka konkluduar në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, duke e konsideruar të përshtatshëm subjektin e rivlerësimit, në përputhje me atë që përcakton raporti i DSIK-së në brendinë e tij, e cila është e përshkruar në pjesën arsyetuese të Komisionit. Gjithashtu, konstatohet krejt pa efekt edhe vendosja gabim e datës së seancës gjyqësore, e cila gjithashtu nuk ka prodhuar asnjë konsekuencë në vendimmarrjen e Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, Komisioni ka konstatuar vetë këto gabime materiale dhe i ka ndrequr ato me vendimin nr. 108/3, datë 19.04.2019, duke shëruar në këtë mënyrë edhe formalisht këto anomali të shkrimit, të cilat janë konstatuar në vendim. Vetë ekzistenca e dispozitave ligjore që parashikojnë e rregullojnë ndreqjen e gabimeve materiale, të gjendura në nenin 120 të Kodit të Procedurave Administrative, tregojnë për mundësinë potenciale të kryerjes së këtyre gabimeve, të cilat konsiderohen njerëzore dhe të ndreqshme nga vetë organi që ka përpiluar aktin, për sa kohë që ato nuk kanë prodhuar apo nuk kanë shërbyer për marrjen e një vendimi të organit publik. Në këto rrethana, Kolegji çmon se pretendimi për gabimet e pasaktësitë e vendimit, që përveç se janë të ndrequra në përputhje me ligjin, nuk rezultojnë të kenë cenuar asnjë të drejtë të subjektit nga procesi i rivlerësimit dhe të tilla ato shihen se nuk kanë asnjë relevancë në raport me drejtësinë e vendimmarrjes.

10. Lidhur me pretendimin e subjektit se procedura e zhvilluar gjatë seancës dëgjimore publike është e parregullt, pasi nuk janë debatuar provat e sjella prej subjektit të rivlerësimit, por ato vetëm janë përmendur shkarazi dhe se i është refuzuar thirrja e dëshmitarëve për marrjen e dëshmive prej tyre, konsiderohen si të pabazuara pasi, siç rezulton nga procesverbali i seancës dëgjimore publike, komisionerja relatores ka bërë një referim të gjatë e të plotë të gjetjeve e rezultateve të hetimit, tek i cili ka përmendur të gjitha çështjet e analizuar lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë e të aftësive profesionale dhe ka deklaruar se e konsideron subjektin se nuk ka kontakte të papërshtatshme, në kuptim të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës.

10.1 Gjithashtu në këtë seancë dëgjimore, për çdo çështje të hetuar gjatë hetimit administrativ, komisionerja relatores ka deklaruar se subjekti ka paraqitur prova apo prapësime të cilat do të vlerësohen me objektivitet gjatë procesit të vendimmarrjes. Administrimi i seancës dëgjimore të kryer nga Komisioni nuk rezulton të ketë penalizuar, penguar apo mohuar subjektin, të drejtën që gjatë kësaj seance të shpjegojë më gjatë apo të ndalet me analiza më të detajuara mbi provat e sjella prej tij. Nga ky akt procedural, rezulton se subjekti ka dhënë shpjegime për atë që ai ka vlerësuar të nevojshme si mbi mënyrën e jetesës apo dhe çështje të caktuara, të cilat janë analizuar nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, konstatohet se subjekti të rivlerësimit i janë drejtuar pyetje dhe ai ka dhënë përgjigje, edhe prej vëzhguesit

ndërkombëtar, lidhur me situata e marrëdhënie me personat e tjerë të lidhur, duke realizuar në këtë mënyrë një seancë dëgjimore efektive e të paanshme.

Në përfundim, Kolegji vlerëson se fakti që Komisioni kryen procesin e vlerësimit të provave të sjella nga subjekti në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar, është një veprimtari procedurale e cila nuk ka një kohë të përcaktuar qartësisht se kur duhet të kryhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Është me rëndësi thelbësore dhe e detyrueshme për zbatim, që Komisioni të trajtojë e analizojë këto prova krahas provave të mbledhura prej atij vetë nga hetimi, para marrjes së vendimit përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, duke i garantuar subjektit në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes dhe zbatimin e parimit të kontradiktoritetit. Ajo që është e rëndësishme në fazën e hetimit administrativ dhe detyrueshme për zbatim me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, është njohja e subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit paraprak, të cilat përfaqësojnë në thelb rezultatin e pritshëm të procedurës administrative sipas nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative dhe kalimin e barrës së provës për gjetjet e hetimit sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim njoftimin dhe vënien në dijeni të subjektit për situatën e tij në procedim dhe dhënien atij të mundësisë për të paraqitur prova e shpjegime. Nga analiza e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka vlerësuar e analizuar provat e sjella nga subjekti⁷ dhe ka mbajtur qëndrimin e tij në raport me to, duke⁸ zbatuar në këtë mënyrë detyrimin ligjor jo vetëm për zhvillimin e një procesi të rregullt, por edhe për marrjen e një vendimi të drejtë në zbatim të neneve 45, pika 1 e 51 të ligjit nr. 84/2016.

11. Në ankim, subjekti pretendon se analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi një analizë ligjore të provave të paraqitura dhe as çmuarjen ligjore të tyre, duke passjellë që lidhur me pasurinë të keqinterpretohet ligji kushtetues (neni D i Aneksit të Kushtetutës) dhe ligji organik (neni 61, pikat 1 e 3 të ligjit nr. 84/2016). Subjekti pretendon e analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi gjatë procesit të tij të rivlerësimit nuk u gjetën pasuri të fshehura apo më të mëdha sesa mund të justifikohen ligjërisht, duke pretenduar se pika 4 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës legjitimon deri në 2-fishin e pasurisë së ligjshme, pasi tejkalimi i këtij pragu e prezumon aplikimin direkt të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

11.1 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, të analizuar në raport me sa është shprehur në vendim për shkaqet që kanë çuar Komisionin drejt dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, konstatohet se kjo masë është dhënë pasi Komisioni, pas kontrollit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, e cila e vendos atë në kushtet e parashikuara nga nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të një deklarami të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë. Gjithashtu Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur një trajtim me çmim preferencial në blerjen e pasurive të paluajtshme garazh dhe apartament, në Tiranë, të rrjedhur si pasojë e ushtrimit të funksionit/detyrës, pasi rezulton se prej tij është dhënë një vendim gjyqësor në favor të ortakëve të kompanisë ndërtuese, me të cilët kishte lidhur kontratë sipërmarrjeje për blerjen e pasurisë apartament dhe garazh (çështje e cila do të shqyrtohet në vijim).

11.2 Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se vendimi i Komisionit në asnjë pjesë të tij nuk mban qëndrim apo konstaton se pasuria e subjektit të rivlerësimit është më shumë se 2-fishi i

⁷ Referohuni në paragrafin 34.9.1; paragrafin 36.3; paragrafin 46/i të vendimit të Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019.

pasurisë së ligjshme, por argumenton se subjekti ndër vite ka pasur mungesë të burimeve financiare/të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë, apo për shlyerjen e huave të marra nga personat të tjerë të lidhur, si dhe të likuiditeteve. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji do të analizojë në mënyrë të detajuar shkaqet e ankimit që lidhen me pasurinë duke i dhënë në këtë mënyrë përgjigje edhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mungesë të analizës së provave respektivisht sipas çështjeve të ngritura në ankim.

Pavarësisht analizës në vijim, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit se pasuria e krijuar prej tij nuk është sa 2-fishi i pasurisë së ligjshme dhe, si e tillë, nuk duhet të përbëjë shkak për shkarkim, është i pabazuar dhe jorelevant për shqyrtim në raport me zgjidhjen e çështjes, sa kohë Komisioni nuk e ka përdorur këtë situatë ligjore si një shkak për shkarkimin e subjektit, por ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kontrollin e kriterit të pasurisë

12. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit nuk është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht konkluzioni i Komisionit se prej tij nuk është deklaruar saktë çmimi për metër katror i apartamentit në {***}, Tiranë, pasi referuar akteve të administruara, si kontrata e sipërmarrjes dhe ajo e kalimit të pronësisë, rezulton se vlera e kësaj pasurie ka mbetur e njëjtë.

12.1 Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji vëren se në vendimin e Komisionit për çmimin për metër katror të apartamentit të subjektit në {***}, Tiranë, është konstatuar se:

33.1. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka porositur pranë shoqërisë "{***}" ShPK, më datë 15.06.2007, një apartament me sip. 159,5 m², Kulla "{***}", në shumën 65701 euro, me kusht që kjo shumë të likuidohej brenda vitit 2009. Në fakt shuma është likuiduar pjesërisht në vitin 2007 dhe plotësisht me formalizmin e kontratës së shitjes, datë 15.07.2013.

33.2 Sipas mandatarkëtimeve nr. {***}, datë 18.04.2007 dhe nr. {***}, datë 15.06.2007, të depozituara nga shoqëria ndërtimore "{***}" ShPK, subjekti ka paguar paraprakisht dy këste në shumën 20000 euro dhe në korrik 2013 ka përfunduar shlyerjen e pagesës së kësaj pasurie me shumën 25571 euro. Konstatohet se një këst është paguar më datë 18.04.2007, dy muaj përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, konstatohen mospërputhje në sipërfaqen e apartamentit të porositur krahasuar me atë të finalizuar në kontratën e shitjes. Konkretisht, sipërfaqja e apartamentit në kontratën e sipërmarrjes është specifikuar 159,5 m², ndërsa në kontratën e shitjes ajo është specifikuar 141,4 m².

33.3 Shoqëria ndërtimore, në informacionin e dhënë, ka sqaruar se ZVRPP-ja nuk ka pasqyruar sipërfaqet e përbashkëta në vërtetimet e pronësisë dhe, për pasojë, kontrata e shitjes nr. {***}, datë 15.07.2013, është lidhur vetëm për sipërfaqen e shfrytëzueshme të apartamentit 141,4 m², edhe pse shuma 65751 euro e paguar nga subjekti, ka përfshirë edhe çmimin e sipërfaqes së përbashkët të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes lidhur mes palëve, më datë 15.06.2007.

33.4 Nga hetimi i kryer, është konstatuar se:

- i. Shuma 65751 euro, e paguar nga subjekti, në raport me sipërfaqen 159,5 m², korrespondon me çmimin 412 euro/m² dhe jo 465 euro/m², sikundër specifikohet në kontratën e shitjes së pasurisë. Thënë ndryshe, shuma e paguar prej 65.751 eurosh përfaqëson vetëm përfitimin e sipërfaqes së shfrytëzueshme.
- ii. Për pasojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me çmimin e paguar për m².

12.2 Në lidhje me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në pronësi të tij pasurinë apartament banimi të ndodhur në {***}, Tiranë. Kjo pasuri është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratat vjetore periodike të pasurisë (në vijim “DVP”) të vitit 2007, 2013 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, me deklarimet si në vijim.

- Në DVP-në e vitit 2007: kontratë sipërmarrjeje me {***}ShPK, e panoterizuar, duke specifikuar se kjo kontratë i përket një apartamenti 3+1 dhe se janë paguar 2 (dy) këste nga 20.000 euro.
- Në DVP-në e vitit 2013: kontratë e blerjes së apartamentit me shoqërinë {***}ShPK me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 15.07.2013, me vlerë 65751 euro, me sip. 141,4 m², në {***}.
- Në deklaratën *vetting*, për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: “Jam bashkëpronar sipas Kodit të Familjes, së bashku me bashkëshorten time, të një apartamenti me sip. 141,4 m², nr. {***}, kati {***}, shkalla {***} e godinës {***}-katëshe, nr. {***}, {***}, të regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. {***}, datë 19.07.2013. Vlera: 65.761 euro.

12.3 Në analizë kronologjike të kontratave të lidhura nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë {***}ShPK, për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, në {***}, lidhur me çmimin e saj konstatohet sa vijon.

- i. Në kontratën e sipërmarrjes, e cila mban datën 15.06.2007 (të deklaruar në DVP 2007), përcaktohet se apartamenti do të ketë një sipërfaqe prej 159,5 m² ne Kullën “{***}” dhe se planimetria dhe gent-plani janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në këtë kontratë sipërmarrjeje, në nenin 3⁹ të saj, është përcaktuar se për realizimin e apartamentit prej 159,5 m², porositësi do t’i paguajë sipërmarrësit një shumë prej 65.701 eurosh.
- ii. Në kontratën e shitjes së apartamentit me nr. {***} rep. dhe nr. {***}kol., të datës 15.07.2013, përcaktohet shitja e një apartamenti me sipërfaqe 141,4 m², i ndodhur në {***}, shkalla {***}, kati {***}, pasuri e cila mban numrin {***}, në zonën kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}. Në këtë kontratë, në nenin 2 përcaktohet se çmimi i shitjes së apartamentit është përcaktuar 465 euro për m² dhe se në total vlera e apartamentit është 65.751 euro, e cila është likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale me këste.

12.4 Duke analizuar rrethanat e përshkruara më lart, rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2007, në të cilën gjendet deklarimi i parë i subjektit në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar të dhënat e kontratës së sipërmarrjes që lidhen me shoqërinë që ka marrë përsipër ndërtimin, strukturën e apartamentit dhe faktin që janë paguar dy prej kësteve të çmimit, në vlerën prej 20.000 eurosh secili. Nuk rezulton që në këtë deklaramin subjekti të ketë deklaruar çmimin për metër katror të kontraktuar me kompaninë ndërtuese. Më pas në DVP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar lidhjen e kontratës së shitblerjes, sipërfaqen dhe vlerën e apartamentit, deklarim i cili është i njëjtë me atë që ka kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*.

12.5 Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin e pasurisë nga të zgjedhurit publikë dhe nga disa nëpunës të lartë të administratës publike”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) përcaktohet se subjektet deklaruuese duhet të deklarojnë në deklaratat periodike vlerat e pasurive dhe të detyrimeve të tyre.

⁹ Në nenin 3 të kontratës së sipërmarrjes është përcaktuar se:

“Palët e kësaj kontrate bien dakord që porositësi t’i paguajë sipërmarrësit për realizimin e apartamentit me sip. 159,5 m² një shumë prej 65.701 eurosh”.

Në dispozitat e ligjit të mësipërm nuk gjendet asnjë parashikim që të ngarkojë me përgjegjësi subjektet deklaruese për deklarimin e çmimit për metër katror, kur ato fitojnë në pronësi pasuri të paluajtshme, por sigurisht që kërkohet deklarimi i vlerës së shpenzuar përgjatë viti kalendarik për krijimin e këtyre pasurive, elementet e pasurisë të detyrueshme për t'u deklaruar sipas legjislacionit të mësipërm, janë të reflektuara edhe në modelet e deklaratave të deklarimit të pasurisë të aplikuara ndër vite, nga vitit 2003 e deri aktualisht, të miratuara nga Inspektori i Lartë, te të cilat nuk gjendet asnjë rubrikë e cila të detyrojë subjektet të deklarojnë çmimin për njësi të pasurive të fituara prej tyre, ndërsa sigurisht kërkohet të deklarohet vlera e plotë e shpenzuar, të dhënë të cilën subjekti rezulton ta ketë deklaruar në përputhje me kontratën e sipërmarrjes. Duke vijuar më tej, vërehet se edhe në ligjin nr. 84/2016 si në përmbajtje të tij, ashtu edhe në shtojcën 2¹⁰, të njohur ndryshe si deklarata *vetting*, kërkohet nga subjektet të deklarojnë vlerat e pasurive të tyre të paluajtshme, si dhe sa ata kanë shpenzuar/paguar deri në datën e plotësimit të kësaj deklarate, por ajo në asnjë rubrikë të saj nuk kërkon të deklarohet çmimi për m² apo për njësi i pasurive.

Për sa u analizua më lart, Kolegji çmon se evidentimi i çmimit për m² të pasurive të paluajtshme është një e dhënë e përfituar nga analizat që kryejnë organet e kontrollit të pasurisë (ILDKPKI), e më pas organet e rivlerësimit gjatë këtij procesi, me qëllim kontrollin e saktësinë e deklarimeve apo në drejtim të verifikimit të ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit apo ndonjë trajtimi preferencial, por ajo nuk është një e dhënë e detyrueshme për t'u deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat periodike, për pasojë mosdeklarimi i kësaj të dhëne nuk mund të kualifikohet në asnjë prej rasteve të shkeljes së legjislacionit që rregullon procesin e rivlerësimit dhe as deklaratimet periodike në vite të subjektit të rivlerësimit.

12.6 Në përfundim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me mosdeklarimin prej subjektit të rivlerësimit për çmimin për m² të pasurisë apartament duke e konsideruar atë si një deklarim të pasaktë, është i pabazuar në ligj dhe pretendimi i subjekti është i drejtë për sa më sipër.

12.7 Nga ana tjetër, Kolegji analizoi edhe diferencën në dukje të çmimit për metër katror të kësaj pasurie, nga kontrata e sipërmarrjes e lidhur në vitin 2007 tek ajo e shitjes së kësaj pasurie e lidhur në vitin 2013. Në analizë të deklarimit të pasurisë apartament në drejtim të vlerave të shpenzuara nga subjekti për pasurinë apartament me sip. 159,5 m² në Tiranë, në {***}, konstatohet se:

- i. Në DVP-në për vitin 2007, prej subjektit të rivlerësimit është deklaruar lidhja e një kontrate sipërmarrjeje (jo noteriale) mbi bazën e të cilës subjekti ka paguar 2 këste, me vlerë 40.000 euro, por në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar as vlerën e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes për blerjen e këtij apartamenti e as sipërfaqen e tij.
- ii. Vlera e apartamentit është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DVP-në për vitin 2013, me vlerë totale 65.751 euro, me sipërfaqe 141,4 m².
- iii. Në deklaratën *vetting*, nga subjekti i rivlerësimit vlera e apartamentit është deklaruar me vlerë totale 65.751 euro, me sipërfaqe prej 141,4 m².

12.8 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar si nga ILDKPKI-ja, por edhe nga ZRVPP-ja Tiranë, kontratën e shitblerjes dhe kartelën e pasurisë apartament të subjektit në

¹⁰ Në deklaratën “*vetting*”, për pasuritë kërkohet: “Përshkrimi i hollësishëm i llojit, sipërfaqes adresës ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes në mungesë të krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”.

Tiranë, në {***}. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit t'i vërë në dispozicion kontratën e porosisë të lidhur prej tij me kompaninë {***}(e cila nuk disponohet nga ZRVPP-ja), të deklaruar në DVP-në e vitit 2007, e cila i është vënë në dispozicion nga subjekti.

Duke krahasuar të dhënat e këtyre kontratave, rezulton se ndërsa në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2007 apartamenti përshkruhet me një sipërfaqe prej 159,5 m² dhe çmim në vlerën 65.701 euro, pra me një çmim 411,91 euro për m², në kontratën e shitblerjes së pasurisë e lidhur në vitin 2013, apartamenti përshkruhet me një sipërfaqe 141,4 m², për një vlerë prej 65.751 eurosh, pra 465 eurosh për m².

12.9 Nga korrespondenca që Komisioni ka pasur me shoqërinë ndërtuese {***}ShPK¹¹, kjo e fundit ka shpjeguar se sipërfaqja 141,4 m² përfaqëson sipërfaqen e shfrytëzueshme të apartamentit të blerë nga subjekti, ndërsa sipërfaqja prej 159,5 m², e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, ka qenë sipërfaqja tek e cila kanë qenë të përfshira edhe sipërfaqet e përbashkëta. Në analizë edhe të kontratave të tjera, të paraqitura në Komision prej ZRVPP-së Tiranë¹², për shitjet e apartamenteve në objektin ku gjendet edhe apartamenti i subjektit, rezulton se gjenden edhe apartamente të tjera të shitura individëve të ndryshëm me çmime të njëjta ose të ngjashme me atë të subjektit të rivlerësimit. Këto rrethana, të cilat janë pretenduar edhe nga subjekti në ankimin e tij, e bindin Kolegjin se diferenca në çmimin e llogaritur për m² për këtë pasuri, por pa ndryshuar vlerën totale të blerjes së saj, shpjegohet me përcaktimin si sipërfaqe e kaluar në pronësi sipas kontratës së shitjes, sipërfaqen e shfrytëzueshme të apartamentit dhe jo atë që është në bashkëpronësi e shfrytëzim të përbashkët me bashkëpronarët e tjerë.

Ky konkluzion, i cili mbështetet edhe në një interpretim logjik të të gjitha të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi, e bëjnë këtë tregues, diferencën në çmimin e shitjes për njësi, nga kontrata e sipërmarrjes tek ajo e shitjes, pa relevancë për nxjerrjen e ndonjë konkluzioni që mund të çonte në ndonjë kualifikim ligjor me pasojë për procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, që edhe kjo diferencë, në dukje, mbetet në fakt një diferencë virtuale, pasi subjekti realisht ka paguar një vlerë të caktuar edhe për sipërfaqet në bashkëpronësi, pavarësisht se ato nuk bëjnë pjesë në aktin e shitjes lidhur mes tij dhe shoqërisë sipërmarrëse. Për më tepër, nisur nga fakti që edhe për individë të tjerë të cilët kanë lidhur me këtë shoqëri kontrata për shitblerjen e apartamenteve në të njëjtin objekt, përafërsisht në të njëjtën kohë, nuk konstatohen diferenca të rëndësishme në çmimin për m², Kolegji arrin në konkluzionin se kjo gjetje nuk prodhon asnjë pasojë ligjore në këtë proces për subjektin e rivlerësimit, qoftë për sa i përket vërtetësisë së

¹¹ Në përgjigjen e saj të datës 20.09.2018, kompania "{***}" ShPK ka shpjeguar sa vijon:

"Duke qenë se ZRVPP Tiranë nuk ka pasqyruar sipërfaqet e përbashkëta në vërtetimet e pronësisë, kontrata përfundimtare e shitjes nr. {***}, datë 15.07.2013, te notere M. S., është lidhur vetëm për sipërfaqet e shfrytëzueshme të apartamentit, pra për sipërfaqen 141,4 m² dhe shuma prej 65.701 eurosh, e paguar nga pala blerëse, z. Hysni Demiraj, për blerjen e apartamentit të mësipërm, ka të përfshirë në çmim edhe sipërfaqen e përbashkët ashtu sikurse është parashikuar edhe në kontratën e sipërmarrjes lidhur mes palëve më datë 15.06.2007".

¹² ZRVPP Tiranë, me anë të shkresës së saj nr. {***} prot., datë 05.12.2018, i ka përcjellë Komisionit disa kontrata shitblerjeje apartamentesh në bllokun e pallateve të ndërtuara nga kompania "{***}" ShPK, ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti, ndër të cilat rezultojnë edhe kontrata shitblerjesh apartamentesh me çmime si në vijim.

<u>Pasuria</u>	<u>Sip</u>	<u>Cmimi euro</u>	<u>Euro/m2</u>
6/264+2-19	66,5	30.922	465
6/264+2-4	99	49.500	500
6/264+2-1	112,5	52.300	465

deklarimeve të tij, qoftë për sa i përket analizës financiare për të kontrolluar aftësinë e subjektit për financimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie. Pavarësisht këtij arsytimi, kjo analizë do të jetë e përdorshme sërish prej Kolegjit në vijim, në trajtimin që do t'i bëhet situatës së konfliktit të interesit dhe trajtimit preferencial, për të cilin subjekti ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit.

12.10 Në analizë të akteve të administruara në fashikull, dhe konkretisht praktikës së sjellë nga ZRVPP Tiranë, vërehet se gjenden edhe kontrata të tjera shitblerjesh në kompletin e pallateve ku ka apartamentin subjekti, si dhe në objektet përreth tij të ndërtuara nga kompania {***}ShPK, ku rezulton se kjo kompani ka disa kontrata shitjesh me çmim nga 465 euro/m² deri në 600 euro/m², aq sa është edhe ai i apartamentit të subjektit të rivlerësimit.

12.11 Në përmbledhje të sa analizuar më sipër, konstatohet se:

- i. Ligji nr. 9049/2003 për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, e më pas ligji nr. 84/2016 nuk kërkojnë që subjektet të deklarojnë çmimin për m² të pasurive të paluajtshme.
- ii. Subjekti në asnjë prej deklarimeve të tij periodike, por as në atë *vetting*, nuk ka deklaruar çmimin për m² të apartamentit.
- iii. Të dhënat mbi ndryshimin e çmimit për m², duke konsideruar vlerën e kontratës së sipërmarrjes dhe atë të shitblerjes në raport me sipërfaqen respektive të tyre, ku konstatohet se çmimi nga kontrata e sipërmarrjes tek ajo e shitblerjes nuk ka ndryshuar, ndërsa sipërfaqja e kontratës së shitblerjes është më e vogël se ajo e sipërmarrjes, Kolegji vlerëson se nuk evidentojnë elemente që imputojnë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe, në këto kushte, nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore.

13. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pasurinë garazh, sipas të cilave konkluzioni i Komisionit se ka mospërputhje mes sipërfaqes së kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratën periodike të vitit 2013 me atë të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe konkluzioni se ai ka kryer deklarim të pasaktë të vlerës së blerjes së garazhit, referuar diferencave mes vlerës së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* e deklaratën e pasurisë të vitit 2013 me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë të viteve 2010 deri 2012, janë të padrejta e të pabazuara ligjërisht. Kolegji shqyrtoi faktet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, duke i analizuar ato si më poshtë.

13.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi një garazh me sipërfaqe 29,2 m², i ndodhur në katin nëntokë të apartamentit në pronësi të tij, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. {***}, datë 19.07.2013, me vlerë 8000 euro. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime fillestare në DPV-në e vitit 2009, në të cilën ka deklaruar se ai ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., për një garazh në Kullën “{***}”, kati nëntokë dhe pagimi i shumës prej 12.500 eurosh do të bëhet me këste, sipas përcaktimeve në kontratë. Më pas, në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se ai ka prenotuar një garazh me sipërfaqe 15 m², me vlerë 12.500 euro, për të cilin janë paguar këtë vit 4000 euro. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se në raport me detyrimin ndaj shoqërisë “{***}”, ai ka shlyer për këtë vit shumën prej 2000 eurosh. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin e shoqërisë {***} për blerje garazhi me vlerë 12.500 Euro, në vlerën 500 euro për këtë vit. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar se ka lidhur kontratën e blerjes së garazhit nga shoqëria “{***}”, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë

15.07.2013, me sip. 29,2 m², e regjistruar në regjistrin përkatës me vlerë 8000 euro, nga të cilat janë paguar në vitin 2013, vlera 2000 euro.

13.2 Nga kontrata noteriale e sipërmarrjes për blerjen e ndërtimin e garazhit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.07.2009, e lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe kompanisë {***}ShPK, për sipërfaqen dhe vlerën e garazhit është përcaktuar se palët bien dakord që porositi (subjekti rivlerësimit) t'i paguajë sipërmarrësit (shoqërisë {***}ShPK) për realizimin ndërtimin e garazhit vlerën prej 12500 eurosh. Kjo pagesë do të kryhet sipas mundësive të klientit, me kusht që deri në dorëzimin e garazhit të jetë dorëzuar e gjithë shuma.

13.3 Konstatohet se në përmbajtjen e saj nuk është specifikuar sipërfaqja e garazhit, por vetëm është dhënë vlera e tij, prej 12500 eurosh. Gjithashtu, në aktet e administruara në fashikull, mungon aneksi bashkëlidhur kësaj kontrate, tek i cili duhet të ndodhej planimetria dhe gentplani që, sipas nenit 1 të kontratës së sipërmarrjes, janë pjesë përbërëse e saj. Ndërsa sipas kontratës së shitblerjes së garazhit, të lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe kompanisë {***}ShPK, më datë 15.07.2013, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., rezulton se objekti i kontratës është shitja e pasurisë së paluajtshme dhe kalimi i titullit të pronësisë nga shitësi te blerësi i një garazhi të ndodhur në Tiranë, në pronësi të {***}ShPK, e regjistruar në ZRVPP Tiranë me nr. {***}, me sipërfaqe 29,2 m², i ndodhur në {***}, kati nëntokë i godinës {***}-katëshe. Pasuria mban numrin {***} dhe ndodhet në zonën kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}. Çmimi i garazhit në kontratën e shitblerjes është 8000 euro, i cili është likuiduar nga palët jashtë zyrës noteriale. Subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ dhe në ankim se reduktimi i çmimit, nga 12500 euro në 8000 euro, për këtë pasuri ka ardhur për shkak të cilësive të dobëta të punimeve, duke depozituar me cilësinë e provës për të provuar këtë pretendim dokumentin "Procesverbal dorëzimi" i datës 12.07.2013, i cili i është përcjellë Komisionit nga kompania ndërtuese {***}ShPK, i cili rezulton të jetë mbajtur disa ditë para lidhjes së kontratës së shitblerjes, në të cilin është përcaktuar se: *pas verifikimit në terren të pronës objekt dorëzimi, u konstatuan të meta të rëndësishme që ndikojnë në funksionalitetin në tërësi të pronës, ndaj pala sipërmarrëse/investitori, për efekt kompensimi të të metave të konstatuara që vijnë si rrjedhojë e defekteve në punime dhe cilësi si rrjedhojë e lagështisë, bie dakord të ulë çmimin e shitjes së këtij garazhi nga 12500 euro që palët kanë përcaktuar si çmimin në kontratën e porosisë, në çmimin final prej 8000 eurosh*, si edhe aktin e ekspertimit të dy inxhinierëve të licencuar, Ing. S. K. dhe L. K., i cili pasqyron gjendjen reale të objektit në momentin e shitjes. Subjekti, në ankim, lidhur me të dhënat teknike të garazhit, ka shpjeguar se në tërësi të gjitha të ashtuquajturat "garazhe" të pallatit ku ai banon, janë vetëm poste parkimi në hapësirën ndërmjet kolonave të katit të nëndheshëm dhe se nuk kemi të bëjmë me një garazh të mirëfilltë me mure ndarëse, i cili për më tepër është në një gjendje të keqe dhe se për të konfirmuar gjendjen e tij i ka kërkuar Komisionit të dërgojë ekspertë për këqyrjen e kësaj pasurie.

13.4 Në ankim subjekti ka potencuar pretendimin kundër qëndrimit të Komisionit se ai ka kryer deklaram të pasaktë dhe se ka mospërputhje në deklarime midis atyre periodike dhe atij *vetting*, në lidhje me çmimin e blerjes së garazhit, duke argumentuar se ndryshimi i çmimit, siç përshkruhet në aktet e cituara më lart, ka ardhur si pasojë e defekteve e të metave të konstatuara në punimet e objektit dhe duke ndjekur një logjikë ekonomike për të cilën janë dakorduar vetë palët kontraktuese. Në analizë të pretendimeve të subjektit lidhur me konkluzionet e Komisionit për pasaktësitë në deklarimin e sipërfaqes së garazhit, rezulton se nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit, është e pamundur të konkludohet nëse, në kohën e deklarimit të sipërfaqes së garazhit prej 15 m² në DPV-në e vitit 2010, sipërfaqja e garazhit të prenotuar prej subjektit ka qenë aq sa ai ka deklaruar në DPV. Në fashikull nuk gjendet ndonjë dokument që të

saktësojë se sipërfaqja e prenotuar ka qenë 15 m² apo e ndryshme. Në këtë kontekst, Kolegji konstaton se ky deklaram i subjektit mbetet deklarativ dhe duhet analizuar në raport me sipërfaqet e garazheve të tjera në njëjtin objekt, sipas të dhënave të përcjella nga ZRPP-ja në Komision.

13.5 Nga këto akte dhe konkretisht nga praktika e sjellë nga ZRVPP Tiranë për regjistrimin e apartamenteve dhe garazheve në kompleksin e objekteve të ndërtuara në zonën në fjalë nga kompania {***}ShPK, rezulton se në Kullën “{***}” ka pasur garazhe me sipërfaqe 13,5 m², 14,7 m², 30 m² dhe vetëm një garazh është me sipërfaqe 29,2 m². Gjithashtu, rezulton se kompania ndërtuese {***}ShPK ka shitur në këtë objekt edhe garazhe të tjera, me vlerë rreth 7000 euro, por sipërfaqet e tyre janë me sipërfaqe më të vogla se 29,2 m², e cila është sipërfaqja e garazhit të blerë prej subjektit.

13.6 Në rrethanat e mësipërme, Kolegji çmon se deklarimi i sipërfaqes së garazhit në DPV-në e vitit 2010 si prej 15 m², e cila mbetet e paprovuar nga aktet e administruara në hetim, nuk mund të konsiderohet një deklaram i pasaktë në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi ai mbetet i paprovuar për sa i përket saktësisë së tij, ndërkohë që vetë subjekti pretendon se ai deklaram është një deklaram i gabuar, për mungesë vëmendjeje apo kujdesi. Edhe në rast se do të provohej se garazhi i prenotuar do të kishte një sipërfaqe të ndryshme nga ajo prej 15 m² në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, ky fakt nuk mund të përbëjë një rrethanë që ka relevancë në lidhje me shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që rezulton se sipërfaqja prej 29,2 m², e deklaruar në deklaratën *vetting*, përkon me sipërfaqen që kjo pasuri ka sipas kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit të saj në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe nuk gjenden elemente që të përkufizojnë këtë situatë sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

13.7 Pavarësisht këtij konkluzioni, Kolegji vlerëson se këto të dhëna, diferenca në sipërfaqe së bashku me diferencën në çmim, duhet të analizohen e shqyrtohen në kuadër të shkakut të ankimit që lidhet me gjendjen e konfliktit të interesit e trajtimit preferencial, për të cilën Komisioni ka arritur në konkluzionin se përbëjnë një shkak për shkarkimin e subjektit.

- 14.** Në lidhje me pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial nga shoqëria {***} ShPK, për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë, është i paargumentuar dhe i pabazuar ligjërisht, Kolegji analizoi e mori në shqyrtim të dhënat për çmimet e objekteve apartamente e garazhe të ndodhura në të njëjtën njësi ku ndodhet apartamenti dhe garazhi, pronë e subjektit të rivlerësimit, nën këndvështrimin e konkluzioneve të Komisionit rreth kësaj çështjeje dhe pretendimeve të subjektit të parashtruara në ankim.

14.1 Në vendimin e Komisionit, në lidhje me këtë çështje është konkluduar se: *1. Raporti i shumës së shpenzuar (për m²), nga ana e subjektit të rivlerësimit, për blerjen e pasurisë, apartament dhe garazh, është më i ulët se shumat e shpenzuara (për m²) nga shtetas/blerës të tjerë, referuar për afërsisht kohës në të cilën subjekti ka porositur pasuritë, por edhe kohës kur ai ka formatizuar kontratën e shitjes së tyre. Nisur nga ky konstatim dhe duke pasur në konsideratë edhe faktet e tjera të cituara nga Komisioni dhe që lidhen kryesisht me përfshirjen e subjektit të rivlerësimit si anëtar i trupës gjyquese që ka gjykuar çështjen civile me nr. {***}, datë 08.02.2013, që i përket palës së paditur M. e V. D., është arritur në konkluzionin¹³ se subjekti i*

¹³ Në vendimin e Komisionit nr. 108, datë 15.02.2019, lidhur me çmimin e garazhit arsyetohet se:

- Subjekti i rivlerësimit është përfshirë në konflikt të hapur interesi me përfaqësuesit e shoqërisë ndërtimore ku edhe ka përfutur pasuritë e lartpërmendura, objekt i këtij hetimi administrativ.

rivlerësimi është trajtuar me çmim preferencial në përfitimin e pasurisë apartament dhe garazh, duke passjellë si pasojë edhe realizimin e kontratave fiktive për blerjet e këtyre pasurive.

14.2 Në analizë të këtij pretendimi, së pari Kolegji vëren se në analizën që Komisioni u ka bërë diferencave në çmime për pasurinë e llojit apartament, nuk është pasur në konsideratë përfshirja ose jo e sipërfaqeve të përbashkëta në llogaritjen e çmimit njësi për m², duke prodhuar si rrjedhojë një konkluzion jo të saktë për diferencat mes këtyre çmimeve. Kolegji konstaton se nga analiza e këtyre të dhënave, që janë përfutur prej kontratave të përcjella nga ZRPP e të paraqitura edhe nga subjekti në hetim për shitjen e apartamenteve individëve të tjerë në njëjtin kompleks, nën këndvështrimin e mësipërm, nuk evidentohen diferenca të tilla që e çojnë Kolegjin në konkluzionin së subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin e tij me një çmim prej 465 euro për m², i cili është më i ulët se ai i individëve të tjerë. Sipas këtij krahasimi, Kolegji konstaton se mes kontratave ka shitje të apartamenteve me çmime më të larta, por edhe më të ulëta se ajo që i takon subjektit të rivlerësimit, ashtu siç ka edhe shitje me të njëjtin çmim¹⁴. Gjithashtu, Kolegji mban në vëmendje se çmimi i blerjes së apartamentit, referuar analizës në paragrafin 12.9 të vendimit, ka qenë i paracaktuar që në vitin 2007 dhe ka mbetur i pandryshuar deri në momentin e kalimit të pronësisë dhe se nuk ka rezultuar nga hetimi ndonjë e dhënë e përfituar nga ndonjë agjenci tjetër shtetërore apo private që të provojë se çmimi për metër katror i përfituar prej subjektit në lidhje me apartamentin, të jetë nën vlerën e tregut për atë zonë në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes apo shitblerjes.

14.3 Në konkluzion të kësaj analize mbi faktet e rezultuara gjatë hetimit, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit që subjekti ka blerë apartamentin me një çmim më të ulët se individët e tjerë, duke e konsideruar atë si trajtim preferencial, përveç se nuk është i bazuar në rrethanat faktike, nuk do gjendej i bazuar as në kualifikimin si një trajtim preferencial në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, neni 23, pika 1¹⁵ i ndryshuar, duke qenë se në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007, në të cilën është përcaktuar edhe çmimi për përfitimin e apartamentit, subjekti nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në raport me shoqërinë {***}ShPK, meqenëse konflikti gjyqësor në të cilin janë përfshirë subjekti si gjyqtar dhe ortakët e kësaj shoqërie si palë e paditur, ka ndodhur në vitin 2013, shumë kohë pasi termat e kushtet e kësaj

-
- Çmimi për metër katror i blerjes së pasurisë rezultoi më i ulët se çmimi i përcaktuar në kontratë.
 - Shuma e paguar për pasurinë garazh rezultoi të jetë në raport të zhdrejtë me shumën e paguar sipas kontratave të tjera të shitblerjeve për të njëjtin lloj pasurie, "garazh".
 - Shuma 8000 euro për blerjen e garazhit është saktësuar vetëm në deklaratën për vitin 2013, kohë në të cilën subjekti ka zhvilluar edhe procesin gjyqësor me përfaqësuesit e kësaj shoqërie ndërtimore, në ndryshim nga shuma e deklaruar në vitet e mëparshme, shuma prej 12.000 eurosh.
 - Kontratat e cituara në prapësimet e paraqitura, si dhe akti i ekspertimit nuk ndikojnë në raport me konstatimet e bëra nga Komisioni.

¹⁴ Në analizë të kontratave të shitblerjeve të sjella me praktikën e ZRVPP-së (32 kontrata) për shitblerje të apartamenteve në grupin e pallateve ku ka blerë shtëpinë subjekti i rivlerësimit në Tiranë, në Rrugën e {***}, kompania "{***}" ShPK, rezultoi se:

- 6 kontrata janë shitur me çmimin 465 euro m²;
- 2 kontrata janë me çmimin 361 euro m² dhe 385 euro²;
- 8 kontrata me çmimin 470 deri në çmimin 560 euro m²;
- pjesa tjetër është mbi 600 euro/m² (16 kontrata).

¹⁵ Neni 23, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, parashikonte: "1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji".

marrëdhënieje ishin vendosur jashtë çdo ndikimi të mundshëm ndaj ndonjë interesi të zyrtarit/subjektit.

14.4 Në përfundim, Kolegji arriti në konkluzionin se nuk gjenden në përcaktimin e çmimit për apartamentin e subjektit të rivlerësimit elemente që e kualifikojnë këtë rrethanë si një trajtim preferencial, në kuptim të situatës faktike e parashikimeve ligjore në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies që ka definuar këtë çmim, për pasojë gjendet i pabazuar konkluzioni i Komisionit në këtë drejtim.

14.5 Kolegji analizoi me të njëjtën metodologji pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit për një çmim që duhet konsideruar si trajtim preferencial në lidhje me pasurinë garazh të subjektit të rivlerësimit, ishte i gabuar.

Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave që rezultojnë nga kontratat (8 kontrata) e sjella nga ZRVPP Tiranë pranë Komisionit gjatë hetimit për shitblerjen e garazheve në të njëjtin kompleks në të cilin ndodhet garazhi i subjektit, rezulton se: i) 5 (pesë) garazhe me sipërfaqe nga 13,5 m² deri në 14,7 m² janë shitur me vlerat nga 6.000 deri në 10.000 euro; ii) 2 garazhe me sipërfaqe 20,5 m² janë shitur me vlerë 7.000 euro; dhe iii) garazhi i subjektit me sipërfaqe 29,2 m² është shitur me vlerë 8.000 euro. Edhe nga kontratat e paraqitura prej subjektit bashkë me ankimin, por të cituara si të tilla që në shpjegimet e tij në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimeve¹⁶, nuk rezulton asnjë kontratë e cila të ketë të paktën të njëjtin çmim shitjeje si ai që ka përfituar subjekti i rivlerësimit.

Në këndvështrim të këtyre të dhënave konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka blerë pasurinë garazh me një çmim më të ulët se kjo shoqëri ua ka shitur individëve të tjerë të njëjtin lloj pasurie, konsideruar edhe vetëm çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së lidhur në vitin 2013, sipas së cilës garazhi me sipërfaqe 29,2 m² i shitet subjektit për një vlerë prej 8.000 eurosh. Përveç këtij konkluzioni, Kolegji mban në konsideratë edhe faktin se çmimi dhe sipërfaqja e garazhit të subjektit të rivlerësimit në treguesit e mësipërm, nuk kanë qenë të tilla që në fillimet e lidhjes së kësaj marrëdhënieje të deklaruar se ka nisur me kontratën e sipërmarrjes në vitin 2009. Sipas atyre që janë përmendur më lart, rezulton se kjo marrëdhënie ka nisur mes palëve për një garazh të deklaruar si me sipërfaqe 15 m² dhe për një çmim prej 12.500 eurosh. Këto elemente thelbësore të kësaj kontrate duket se kanë ndryshuar definitivisht në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2013, duke u shndërruar në një garazh me sipërfaqe 29,2 m² për një çmim prej 8.000 eurosh. I vetmi shpjegim që subjekti jep në lidhje me këtë ndryshim të kushteve të kontratës është cilësia e dobët e punimeve, të pasqyruara në “akt dorëzimin” e depozituar prej tij në Komision.

14.6 Në lidhje me këto rrethana, Kolegji çmon se referuar akteve, subjekti nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm faktin se për shkak të defekteve të ndërtimit shoqëria ka ulur çmimin e kontraktuar më parë me subjektin e rivlerësimit për këtë pasuri. Në aktet e sjella nga subjekti në mbështetje të këtij shkaku ankimi, nuk provohet se këto defekte nuk kanë mundur të korrigjohen nga kompania e, në këto kushte, kjo ka passjellë uljen e vlerës së pasurisë garazh, por ato vetëm

¹⁶ Kontrata shitblerjeje të sjella me ankimin nga subjekti kanë të dhënat si në vijim (fashikulli 13, faqe 4381):

<u>Pasuria</u>	<u>Emri</u>	<u>Sip</u>	<u>Çmimi euro</u>	<u>Euro/m2</u>	
6/264+2-19	Fatjon Boci	66,5	30.922	465	Apartament
6/264+2-4	Enklajd Lika	99	49.500	500	Apartament
6/264+2-1	Hasan Lushi	112,5	52.300	465	Apartament
6/264-G19	Ardian Milo	27,6	7.000	253,62	GARAZH
6/264-G7	Zamir Shabani	25,5	6.000	235,29	GARAZH

kanë identifikuar të metat apo defektet. Për më tepër, ky çmim që rezulton të jetë më i ulët se për individët e tjerë, nuk mund të trajtohet i shkëputur nga historiku i marrëdhënies së subjektit me këtë pasuri, sipas vetë deklarimeve të tij në vite, e cila ka nisur për një çmim më të lartë, 12.500 euro dhe për një sipërfaqe më të vogël, 15 m², të cilën subjekti nuk arriti ta provonte se ishte më e madhe në kohën e deklarimit apo kontraktimit si porosi, për t'u konkluduar në një marrëdhënie me terma shumë të favorshëm për subjektin qoftë për sa i përket sipërfaqes, qoftë për sa i përket çmimit.

14.7 Në këto kushte, Kolegji, duke pasur parasysh këto rrethana faktike dhe parashikimin ligjor të nenit 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar¹⁷, i cili parashikon se: *Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat*, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi dot se kushtet më të favorshme të përfituara në kontratën e shitblerjes së garazhit, vinin për shkaqe të tjera objektive e të arsyeshme që nuk kanë lidhje me detyrën e tij, për pasojë, e vetmja arsye e qenësishme që mund të justifikojë këto favorizime mbetet funksioni i gjyqtarit. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se vërtetohet kushti i parashikuar nga neni 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005 për ta trajtuar uljen e çmimit për pasurinë garazh si një trajtim preferencial në kuptim të këtij ligji. Kolegji do të vijojë më tej të arsyetojë mbi çështjen e konfliktit të interesit, e cila lidhet me konkluzionin e mësipërm, në këndvështrim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, duke qenë se sipas përkufizimit të nenit 23, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar atë gjendje, prandaj edhe konkluzioni i mësipërm është parë e trajtuar vetëm në kuptim të ekzistencës së kushteve për të pasur një trajtim preferencial sipas ligjit.

15. Në drejtim të kontrollit të pasurisë, subjekti në ankim ka ngritur pretendimin se nuk janë të drejta dhe të bazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit në drejtim të huadhënësit P. K., pasi sipas tij, ai ka pasur likuiditete në dispozicion, si dhe burime të ligjshme disa herë më të mëdha se shuma e dhënë hua subjektit të rivlerësimit, prej 5.000.000 lekësh, duke pretenduar se për këtë hua prej Komisionit janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme provat e paraqitura nga subjekti. Subjekti ka parashtruar se me qëllim provimin e pasjes së likuiditeteve me burim të ligjshëm nga huadhënësi P. K., ai ka paraqitur në cilësinë e provës në Komision akte, si: kontratën e kredisë nr. {***}, nr. {***}. rep., {***} kol., datë 30.01.2007, lidhur ndërmjet P. K. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë ShA, dega Tiranë, ku kredimarrësi “{***}” ShPK, shoqëri ku P. K. është aksioner, ka marrë një kredi në vlerën 2,5 milionë euro. Komisioni, pas hetimeve të kryera për huan që subjekti ka marrë nga individ P. K., ka konkluduar: *Personi tjetër i lidhur i subjektit të rivlerësimit, shtetasi P. K., nuk justifikon me burime të ligjshme huan e dhënë në shumën prej 5.000.000 lekësh dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve të huas, në shumën 5.000.000 lekë, vit pas viti.*

15.1 Nga ana e Komisionit, në vendim është paraqitur informacion dhe është arsyetuar mbi llogaritë bankare të huadhënësit P. K. në “Tirana Bank”. Sipas të dhënave të vendimit të Komisionit, rezulton se ky shtetas ka pasur llogari të hapura në monedhën euro, lekë, dollarë në “Tirana Bank” përgjatë periudhës 2003-2014, por gjithnjë duke iu referuar periudhës së cilës ai ka dhënë huan, nuk rezultojnë të jenë kryer transaksione dhe burimi i krijimit mbetet i paprovuar ligjërisht, për pasojë, nga vlerësimi në tërësi i informacionit të ardhur nga të gjitha bankat e nivelit të dytë për llogaritë bankare të shtetasit P. K., nuk rezulton që në vitin 2006 ky i fundit të

¹⁷ I ndryshuar me ligjin nr. 86/2012, datë 08.09.2012.

këtë pasur gjendje likuiditeti në bankë për të dhënë hua/borxh shumë prej 5000000 lekësh subjektit. Fakti i mosmarrjes në konsideratë të kësaj të dhëne, shihet nga subjekti si një veprim në kundërshtim të hapur me ligjin. Në lidhje me aftësinë financiare të individit P. K., subjekti në ankim ka pretenduar se ai është ortak në shoqëri tregtare, të cilat kanë pasur një aktivitet të rëndësishëm financiar, të cilat për shkak të informalitetit të kohës nuk kanë regjistruar në bilancet e shoqërisë të ardhurat e krijuara realisht prej tyre.

15.2 Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, si dhe të pretendimeve të subjektit të ngritura në ankim, Kolegji me qëllim evidentimin e gjendjes së likuiditeteve të huadhënësit, z. P. K., verifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të tyre, mori në analizë llogaritë e tij bankare, si dhe identifikimin e burimit të krijimit të tyre.

15.3 Së pari, Kolegji vëren se z. P. K. është cilësuar si person tjetër i lidhur në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka rezultuar të jetë huadhënës i subjektit të rivlerësimit për shumë prej 500.000 lekësh që ka shërbyer si burim për pagimin e dy kësteve të para të çmimit të porositjes së apartamentit, në pronësi të subjektit. Kolegji gjithashtu konstaton se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me huadhënësin P. K. ka qenë një marrëdhënie e formalizuar si e tillë me anë të kontratës së huas me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 27.09.2006. Sipas kësaj kontrate, të deklaruar në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka marrë hua prej P. K. shumë prej 5000000 lekësh, për një afat kthimi prej 12 vjetësh, me të drejtë shtyrjeje me interes 2,5% në vit. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit ndonëse kalon testin e provueshmërisë së ekzistencës formale të kësaj marrëdhënieje, me të drejtë, sipas vlerësimit të Komisionit por edhe të Kolegjit, dështon të kalojë testin e provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit të krijimit të këtyre të ardhurave.

15.4 Kolegji verifikoi në drejtim të dhënies përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, gjendjen e likuiditeteve në banka të z. P. K. deri në kohën para dhënies së huas, sipas kontratës noteriale me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 27.09.2006.

15.5 Nga verifikimi i të dhënave bankare për llogaritë në emër të këtij individit, Kolegji ndryshe nga Komisioni konstaton se ai ka pasur likuiditete gjendje në llogaritë e tij bankare, të tërhequra para dhënies së huas në vlera të cilat mund të mbulonin potencialisht shumë e dhënë hua në vlerën monetare prej 5.000.000 lekësh.

15.6 Pavarësisht këtij konstatimi, Kolegji çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimin e tij se burimi i krijimit të këtyre të ardhurave ishte aktiviteti tregtar i individit P. K., i shtrirë në vite dhe në disa shoqëri që ushtronin aktivitetin e tregtisë së mallrave.

15.7 Në këtë kontekst, nga analiza që u krye për të ardhurat e krijuara nga shoqëritë tregtare ku P. K. ishte ortak, shoqëria “{***}” ShPK, me emër tregtar “{***}” dhe {***}ShPK, referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, gjejmë se rezultoi:

“{***}” ShPK, kompani e cila ka qenë e regjistruar më datë 06.11.1998, me administrator S. N., ndërsa P. K. rezultoi të ketë qenë ortak me 26% pjesë të kapitalit të shoqërisë, deri më 27.03.2007¹⁸, në të cilën, me vendim të asamblesë së ortakëve, është vendosur shitja e kuotave të ortakut P. K., tek ortakët e tjerë. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, nëpërmjet shkresës nr. {***}, datë 14.11.2018, ka informuar për të ardhurat dhe fitimin neto të shoqërisë “{***}”

¹⁸ Në kontratën për shitje kuotash nr.{***}, datë 28.02.2007, rezultoi se shtetasi P. K. ka shitur 1/2 e 33,3% të kuotave që zotëronte me një vlerë të përgjithshme prej 5.300.000 lekësh, veprime të cilat rezultojnë pas datës së dhënies së huas subjektit të rivlerësimit.

ShPK, me numër nipt {***} duke pasqyruar se, me vendim të asamblesë së ortakëve, më datë 11.01.2006, është vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar të kësaj shoqërie me fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme dhe më datë 20.01.2006, është vendosur miratimi i aktit të ekspertit kontabël për të rritur kapitalin themeltar në vlerën 31.800.000 lekë, i cili pas zmadhimit arrin në vlerën 31.900.000 lekë. Deri në janar të vitit 2006, aksionerët e shoqërisë së bashku me aksionerin P. K. nuk kanë përfiturar të ardhura nga shoqëria sepse nuk rezulton të jenë ndarë dividendë në pasqyrat financiare, për ortakët, pasi i gjithë fitimi i mbartur nga viti 1999-2004, është përdorur për zmadhim kapitali themeltar të shoqërisë¹⁹.

15.8 Për sa i përket shoqërisë " {***}" ShPK, rezulton se ajo është regjistruar në Gjirokastrë, më datë 06.04.2004, me NIPT {***}, me përfaqësues ligjor dhe ortak, z. A. T., dhe më datë 23.01.2008, pranë kësaj shoqërie është shtuar si ortak me 45% të kapitalit, shtetasi P. K.. Duke qenë se individi P. K. është bërë pjesë e kësaj shoqërie pasi kohës së dhënies së huas, analiza financiare e të ardhurave të gjeneruara nga shoqëri është jorelevant me çështjen objekt shqyrtimi, për pasojë nuk gjen vend as në arsyetimin e këtij vendimi.

15.9 Rrethanat që konsiderohen relevante e të rëndësishme për Kolegjin, në vlerësimin e shkakut të ankimit, lidhen me analizën financiare të të dhënave për shoqërinë "{***}" ShPK në të cilën P. K. ka qenë aksioner deri në momentin e dhënies së huas, sipas së cilës për periudhën 1996-2006, i gjithë fitimi i shoqërisë është përdorur për rritjen e kapitalit themeltar të vetë shoqërisë dhe nuk iu është shpërndarë si dividend aksionerëve.

15.10 Në lidhje me pretendimin e ngritur në ankim prej subjektit të rivlerësimit se P. K. ka pasur likuiditet për të dhënë hua, pasi ai ka marrë kredi bankare në vlerë prej 2,5 milionë eurosh, nga verifikimi i akteve të administruara në hetim, ka rezultuar se kredia në fjalë është marrë nga shoqëria ku është aksioner P. K. dhe i referohet kontratës së kredisë nr. {***}, nr. {***} rep., {***} kol., datë 30.01.2007, lidhur ndërmjet z. P. K. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë ShA, dega Tiranë, në të cilën figuron si kredimarrës shoqëria "{***}" ShPK. Kredia në vlerën 2,5 milionë euro, ka pasur si destinacion të saj, për shumën prej 1 milion eurosh, të përdorej për nevojat e kredimarrësit për kapitalin e punës, ndërsa 0,5 milion euro do të përdreshin për të paguar kredinë e marrë në vitin 2005 pranë Tirana Bank. Subjekti pretendon se z. P. K. si aksioner i "{***}" ShPK, ka pasur mundësi të qarkullojë likuiditet për shkak të kredisë së marrë pranë Bankës Kombëtare të Greqisë, si dhe në këtë periudhë një pjesë e madhe e transaksioneve financiare kryheshin në *cash*. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision edhe një deklaratë noteriale nr. {***}, datë 04.02.2019, të shtetasit P. K. para noterit, në të cilën ai shpjegon se si kryheshin përgjithësisht veprimet në *cash* gjatë asaj periudhe. Në analizë të këtij pretendimi, konstatohet se kredia e pretenduar e marrë në "Bankën Kombëtare të Greqisë" është marrë nga huadhënësi, z. P. K., më 30.01.2007, për pasojë likuiditet e prodhuara prej saj nuk

¹⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 21.12.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka dërguar dokumentacionin përkatës lidhur me aktivitetin e shoqërisë "{***}" ShPK (me emër tregtar "{***}" ShPK), me NIPT {***}. Në dokumentacion është administruar një kopje e shkresës së dërguar nga shoqëria "{***}" ShPK, Gjirokastrë, më datë 20.06.2006, me lëndë: "Ju dërgojmë vendimin e shoqërisë mbi destinacionin e fitimit të shoqërisë të vitit 2005", në të cilën deklarohet se: "Ortakët e shoqërisë " {***}" në mbledhjen e tyre kanë vendosur që fitimi i pasqyruar në bilancin e vitit 2005 të kalojë në kapital, çka vërteton se edhe në vitin 2006 nga kjo shoqëri nuk është shpërndarë dividend për ortakët e shoqërisë ". Në kontratën për shitje kuotash nr. {***}, datë 28.02.2007, rezulton se shtetasi P. K. ka shitur 1/2 e 33,3% të kuotave që zotëronte me një vlerë të përgjithshme prej 5.300.000 lekësh, veprime të cilat rezultojnë pas datës së dhënies së huas subjektit të rivlerësimit.

mund të kenë shërbyer si burim për huan që ai i ka dhënë subjektit, e cila, referuar kontratës noteriale, është ekzekutuar në shtator të vitit 2006.

15.11 Në këtë kuptim, Kolegji çmon të nënvizojë arsyetimin se pavarësisht që z. P. K. rezulton se ka pasur likuiditet në llogari e tij bankare në shuma të konsiderueshme, edhe përreth periudhave kohore para dhënies së huas objekt verifikimi e shqyrtimi, kjo rrethanë nuk do të barazohet, në këndvështrimin e Kolegjit, me provueshmërinë e burimit të ligjshëm, së pari, për krijimin e këtyre likuiditeteve dhe, së dyti, të shumës prej 5.000.000 lekësh.

15.12 Subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se paratë e dhëna hua prej huadhënësit P. K., kishin si burim të krijimit të tyre pikërisht aktivitetin tregtar, të zhvilluar nga shoqëria {***} ShPK, për sa kohë që nga të dhënat e organeve tatimore, kjo shoqëri nuk rezultonte të kishte ndarë dividend për vitet 1996-2006, dhe të justifikonte në këtë mënyrë fitimin e të ardhurave të ligjshme prej huadhënësit në kuptim të ligjit “Për të ardhurat personale”. Subjekti i rivlerësimit dështoi gjithashtu kundrejt detyrimit ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, të provojë se huadhënësi kishte në ndonjë mënyrë fituar të ardhura të ligjshme në kuptim të parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe as të provonte mekanizmin krijues të këtyre të ardhurave, të cilat i ishin huazuar atij. Vetëm fakti i pasjes së një aktiviteti tregtar dhe gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, së bashku me një prezumim për ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave, për sa kohë që qarkullohen nga sistemi bankar, nuk mjaftojnë për të konkluduar se edhe shuma e dhënë hua, ka doemos një burim të ligjshëm, ndërkohë që nga të dhënat e deklaruara në organet përkatëse, nuk evidentohen për huadhënësin rekorde të fitimit drejtpërdrejt të këtyre të ardhurave.

15.13 Në këto kushte, Kolegji arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, prej huadhënësit P. K., është i drejtë. Duke qenë se kjo shumë ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament, Kolegji çmon se mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e saj afekton drejtpërdrejt burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament, duke e vendosur subjektin në situatën faktike të kualifikuar sipas nenit 33 pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15.14 Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji gjen të paarsyeshëm qëndrimin e Komisionit mbi analizën financiare lidhur me pamundësinë e shlyerjes së kësaj huaje prej subjektit të rivlerësimit përgjatë viteve 2007-2015.

- 16.** Lidhur me pretendimin e subjektit se është i pabazuar në prova konkluzioni i vendimit, se vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk provon se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës prej 30.000 eurosh, të dhëna hua subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim krahas qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi lidhur me këtë çështje.

16.1 Për vëllain e subjektit të rivlerësimit, është kryer analizë ekonomike nga Komisioni, pasi ai bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka cilësinë e personit tjetër të lidhur, pasi është huadhënës i subjektit të rivlerësimit. Në vendimin e Komisionit lidhur me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2013 të vëllai i tij, në vlerën 30.000 euro, është konkluduar se duke vlerësuar të ardhurat nga paga e personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si dhe nga transaksionet bankare, nuk rezulton që huadhënësi të këtë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të vënë në dispozicion hua shumën 30.000 euro në vitin 2013.

16.2 Subjekti i rivlerësimit këtë hua e ka deklaruar në DVP-në e vitit 2013 me shpjegimin se burim krijimi të kësaj shume prej vëllait të tij, z. R. D., është shitja e shtëpisë së banimit në qytetin Bajram Curri . Ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti ka deklaruar se kjo vlerë është përfituar nga vëllai nga shitja e një banese në Tropojë dhe nga të ardhurat e tij ndër vite. Në përgjigjet e dhëna gjatë hetimi administrativ²⁰, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të shumës së dhënë hua, shitjen e dy shtëpive të ndodhura në Bajram Curri. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionit rreth shtëpisë së dytë shitja e së cilës deklarohet si burim krijimi vetëm gjatë fazës së hetimit administrativ dhe nuk është deklaruar si e tillë as në deklaratën *vetting* dhe as në ato periodike, nga ana e subjektit është dhënë përgjigja se kjo shtëpi dhe transaksioni i bërë me të nuk është deklaruar pasi kjo ka qenë e pa regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

16.3 Në vijim të hetimit të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka kontraktuar për blerjen e një apartamenti në Tiranë në vitin 2009, të cilin ai e zotëron edhe sot, por se vetë transaksioni i blerjes së kësaj prone ka pasur modifikime të cilat, sipas pretendimit të subjektit, përgjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim, i ka dhënë mundësi vëllait të subjektit që shumën e përdorur për blerjen e apartamentit të tij në vitin 2009, ta merrte mbrapsht në vitin 2010 dhe t'ia jepte subjektit si hua për të mundësuar financimin e apartamentit të blerë prej tij, objekt verifikimi në këtë proces.

16.4 Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni ka konstatuar se nga verifikimet në ZVRPP, ka rezultuar se të dy bashkëshortët nuk rezultojnë me pasuri, dhe për këtë është pyetur SR për të dhënë shpjegime. SR ka shpjeguar që vëllai me bashkëshorten kanë depozituar pranë ndërtuesit A.M. (në llogarinë e tij) vlerën prej 52.563 eurosh, me qëllim blerjen e një apartamenti dhe, në bazë të një marrëveshjeje verbale mes palëve, me projeksionin që brenda një muaji do të firmosnin kontratën. Pas rreth 2-3 muajsh, vëllai i SR është vënë në dijeni se po përpiquej të blinte një apartament i cili ishte jashtë sferës së qarkullimit civil, pasi pallati ishte pa leje ndërtimi, pa vendim të dhënies së lejes për shesh ndërtimi, i pakolauduar, i palegalizuar dhe i pahipotekuar [...] Ndërtuesi e ka garantuar se brenda një viti do dilte leja e legalizimit, mbështetur kjo në ligjin e ri për legalizimin e ndërtimeve informale [...]. Pas një viti e gjysmë, më datë 10.10.2010, vëllai i ka kërkuar përsëri kthimin mbrapsht të të gjithë shumës, por kanë rënë dakord që nga e gjithë shuma t'i kthehej vlera 42.563 (dyzet e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro duke i lënë pranë ndërtuesit vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro në formë kapari, për të garantuar riblerjen e apartamentit vetëm pasi të jetë formalizuar ndërtimi i pallatit, ose në të kundërt të përllogaritet qiraja e gjithë kohës së qëndrimit të tij në atë apartament. Edhe sot që komunikojmë, vëllai i subjektit banon në atë apartament [...]. Në përfundim, Komisioni, ka argumentuar se nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës 32.000 euro, shumë kjo e pretenduar se ka shërbyer si burim për huan e dhënë, për më tepër, subjekti nuk provoi qarkullimin e shumës 42.563 euro, pra kthimin e saj vëllait të subjektit nga individ A. M.

16.5 Sipas pretendimeve të subjektit, shuma e marrë hua nga vëllai, prej 30.000 eurosh, është përdorur respektivisht:

- i. 25.000 euro, i është paguar shoqërisë "{****}" ShPK, si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit 3+1, sipas kontratës së porosisë, më datë 15.06.2007, ndërkohë që kontrata noteriale e huas me nr. {****} rep., e nr. {****} kol., është nënshkruar më 27.08.2013;

²⁰Në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të datës 07.09.2018, për pyetësin nr. 2, ai lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 30.000 euro të marrë hua nga vëllai i tij me kontratën e huas nr. {****} rep., dhe {****} kol., datë 27.08.2013, deklaroi se ato janë krijuar nga vëllai i tij me burime të ligjshme, të përfituara nga rrogat, shitja e 2 (dy) shtëpive në Bajram Curri dhe në fshatin {****} të rrethit të Tropojës.

- ii. shuma prej 2000 eurosh për të likuiduar tërësisht vlerën e garazhit;
- iii. pjesa e mbetur është përdorur për pagimin e huas²¹ marrë nga P. K..

16.6 Kolegji, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të subjektit lidhur me huan e marrë në vitin 2013 nga vëllai i tij, u ndal në analizimin e dy elementeve të ndërthur njëri me tjetrin, në rastin konkret, verifikimin e mundësisë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. R. D., me cilësinë e personit tjetër të lidhur sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar me burime të ligjshme shumë prej 30.000 eurosh të dhënë hua dhe njëkohësisht, me verifikimin e kësaj mundësie, edhe verifikimin e ekzistencës së vetë marrëdhënies së huas lidhur mes subjektit e vëllait tij, në kuadër të rrethanave që vetë subjekti i rivlerësimit ka prezantuar në proces.

16.7 Në mbështetje të shpjegimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në analizë të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh nga vëllai i subjektit, me qëllim verifikimin e elementeve të përshkruara më lart. Nga verifikimi i dokumentacionit të ZVRPP-ve, rezulton se shtetasi R. D., me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 06.11.2006, i ka shitur shtetasit S.M. apartamentin nr. {***}, të ndodhur në Zonën Kadastrale {***}, me sip. 200 m², nga kjo 106,2 m² ndërtim, në adresën "{***}", Bajram Curri-Tropojë, në vlerën prej 1.500.000 lekë²², e cila është likuiduar krejtësisht përpara përpilimit të kontratës, duke deduktuar se nga kjo shitje personi tjetër i lidhur ka përfutur shumë prej 1.500.000 lekësh.

16.8 Nga dokumentacioni i administruar²³, rezulton se z. R. D. ka pasur numër llogarie të hapur pranë “Intesa Sanpaolo Bank” dhe ka kryer transaksione përgjatë periudhës 2005-2009. Në vitin 2009, pas tri vitesh nga shitja e apartamentit në Tropojë, vëllai i subjektit ka depozituar pranë “Intesa Sanpaolo Bank” shumë prej 32.000 eurosh²⁴, me përshkrim: *Të ardhura nga shitja e shtëpisë*, vlerë e cila është më e madhe se vlera e shitjes së shtëpisë në Tropojë, në vlerën 1.500.000 lekë. Bazuar në transaksionet bankare, më datë 17.04.2009, kjo shumë është tërhequr nga vëllai i subjektit nga banka në *cash*, me përshkrimin: *Për blerje shtëpie*. Sipas dokumentacionit bankar, vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë kryer transaksione bankare më datë 17.04.2009, me vlerë totale 52.000 euro (2.200.000²⁵ lekë + 500.000²⁶ lekë + 32.000²⁷ euro) me destinacion *blerje shtëpie*, në analizë të cilës rezulton se të gjitha likuiditetet e gjendura në sistemin bankar në emër të personit tjetër të lidhur dhe bashkëshortes, janë tërhequr me qëllim financimin e shumës për blerjen e apartamentit të tyre në Tiranë.

16.9 Kolegji, duke analizuar mundësitë e personit tjetër të lidhur për të krijuar me burime të ligjshme shumë prej 30.000 eurosh në vitin 2013, mori në shqyrtim të gjitha të ardhurat që sipas pretendimeve të subjektit janë deklaruar në deklaratën *vetting*, pra nga shitja e shtëpisë në Tropojë në vitin 2006 dhe të ardhurat nga pagat në vite, janë përdorur prej vëllait të subjektit për

²¹ Huas së marrë prej tij, me vlerë prej 5.000.000 lekësh, nga z. P. K..

²² Referuar kursit të këmbimit të kohës, rreth 12.000 euro

²³ Të vëna në dispozicion nga Intesa San Paolo Bank, gjatë hetimit administrativ me anë të shkresës nr. {***}, datë 23.03.2018, si dhe nga Raiffeisen Bank, me anë të shkresës nr. {***}, datë 17.09.2018.

²⁴ Me transaksionin pranë Intesa San Paolo Bank të derdhjes në *cash*, të datës 09.02.2009, në numrin e llogarisë {***}.

²⁵ Me transaksionin pranë Raiffeisen Bank të tërheqjes në *cash*, të datës 17.04.2009, në numrin e llogarisë 878693.

²⁶ Me transaksionin pranë Intesa San Paolo Bank të tërheqjes në *cash* të datës 17.04.2009, në numrin e llogarisë {***}.

²⁷ Me transaksionin pranë Intesa San Paolo Bank të tërheqjes në *cash*, të datës 17.04.2009, në numrin e llogarisë {***}.

të krijuar shumën e dhënë hua prej tij. Në analizë të këtyre të dhënave, përfshirë edhe pagat e bashkëshortes së personit tjetër të lidhur, znj. B. D., si dhe duke analizuar edhe shumën e shpenzuar për kontraktimin e apartamentit në vitin 2009, rezultoi se vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk mundej të kishte në zotërim të tij në vitin 2013 shumën prej 30.000 eurosh, të cilën subjekti deklaroi se ia ka dhënë hua.

Kolegji, në analizën e tij financiare, llogariti çdo të ardhur të deklaruar e të dokumentuar, përfshirë edhe pagat e bashkëshortes, të cilat rezultojnë si të tilla prej *statementit*/vërtetimit bankar, në emër të një analize garantiste dhe pa marrë një qëndrim mbi ligjshmërinë e tyre për efekt të zbatimit të konceptit të të ardhurave të ligjshme sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë zë, nuk u përfshinë të ardhurat e deklaruar nga subjekti se janë realizuar nga shitja e një shtëpie të ndodhur në Tropojë (fshatin{***}), e cila kishte qenë e paregjistruar, pasi për këtë veprim juridik, përveç se të padeklaruar si burim as në deklaratën *vetting* dhe as në atë periodike të vitit 2013, nuk u paraqit asnjë provë shkresore që të provonte këtë veprim të pretenduar prej subjektit. Në këtë analizë, Kolegji gjithashtu konsideroi si shpenzim të kryer nga njësi familjare e personit tjetër të lidhur, vlerën e shpenzuar për blerjen e apartamentit të ndodhur në Tiranë në vitin 2009, pasi vetë subjekti i rivlerësimit, por edhe transaksionet bankare të kryera në këtë kohë, tregojnë për faktin se të gjitha të ardhurat e realizuara prej kësaj njësie familjare, janë përdorur në vitin 2009 për të financuar porositjen e apartamentit dhe, si i tillë, ky është një shpenzim që duhet llogaritur si i zbritshëm nga të ardhurat e përshkruara më lart, meqë vetë subjekti pretendon në këtë mënyrë.

16.10 Në ndjekje të linjës logjike të shpjegimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, Kolegji mori në shqyrtim dhe analizë pretendimin e tij se vëllai i subjektit kishte marrë prej ndërtuesit, z. A. M, shumën prej 42.563 eurosh, si vlerë të kthyer mbrapsht për shkak të parregullsive të ndërtimit, ku personi tjetër i lidhur kishte porositur apartamentin. Në lidhje me këtë pretendim, nga analiza e fakteve që vijnë nga aktet e administruara në hetim, rezultoi se vëllai i subjektit, z. R. D., më 17.04.2009, ka lidhur një aktmarrëveshje të titulluar “për marrjen në dorëzim të çelësave” të një apartamenti në rrugën “{***}”, Tiranë, i lidhur me z. A. M, të cilësuar në këtë kontratë si “ndërtuesi”. Në këtë akt nuk është deklaruar vlera totale e apartamentit, por është deklaruar se janë paguar deri në atë moment 52.563 euro dhe pjesa tjetër do të paguhet brenda një afati të arsyeshëm.

16.11 Nga gjithë sa përshkruar më sipër, mbetet e paqartë dhe jo e provuar me akte mbështetëse, kthimi i shumës prej 42.563 eurosh fillimisht nga ndërtuesi te vëllai i subjektit dhe më pas kalimi i një pjese të saj (30.000 eurosh) si hua te subjekti i rivlerësimit. Kjo situatë bëhet më e paqartë kur nga aktet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, rezultoi që vetë vëllai i tij në momentin e dhënies së huas subjektit nuk kishte përmbushur detyrimet për pagimin e plotë të vlerës së apartamentit të tij ku ai realisht banonte.

16.12 Në drejtim analizimit të të dhënave që lidhen me dhënien e huas nga vëllai te subjekti në vitin 2013, Kolegji analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, prej të cilave rezultoi se:

- Personi tjetër i lidhur R. D., në vitin 2006, ka krijuar të ardhura nga shitja e banesës në Tropojë, në vlerën 1,5 milion lekë.
- Në datën 10.10.2010, R. D. dhe ndërtuesi A. M kanë nënshkruar një deklaratë me shkrim, në të cilën kanë pohuar se z. R. D. ka tërhequr në *cash* vlerën prej 42.563 eurosh nga ndërtuesi M., pasi ka kaluar mbi një vit që nga transferta bankare e datës 14.04.2009, meqenëse ai nuk ka arritur të nxjerrë lejen e legalizimit për objektin ku ndodhej apartamenti. Sipas kësaj deklarate, kjo vlerë do të kthehej te ndërtuesi pasi të legalizohej i

gjithë pallati dhe, nëse nuk arrihej likuidimi, atëherë e gjithë periudha e qëndrimit të personit tjetër të lidhur në këtë apartament do të llogaritet si në një marrëdhënie qiraje, me vlerë 15.000 lekë në muaj, ndërsa vlera prej 10.000 eurosh²⁸ mbetet e depozituar pranë ndërtuesit A. M. Nga kjo deklaratë e datës 10.10.2010, rezulton gjithashtu se po këtë vit, vëllai i subjektit të rivlerësimit ka filluar të banojë në objektin që kishte prenotuar për të blerë në të cilin vazhdon të banojë deri në kryerjen e procesit të rivlerësimit, sipas deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit.

- Më datë 27.08.2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë hua nga vëllai i tij R. D. shumën prej 30.000 eurosh, për të cilën po në këtë datë kanë nënshkruar kontratë noteriale me nr. {***}. Në këtë kontratë përshkruhet se ajo jepet pa interes, me qëllim likuidimin e një apartamenti banimi dhe se afati i shlyerjes së saj është deri më 26.08.2023. Në deklaratë thuhet se kjo shumë është kaluar nga huadhënësi te huamarrësi jashtë kësaj zyre.

16.13 Nisur nga të dhënat e mësipërme dhe ato që lidhen me transaksionet e shumave monetare të përshkruara më lart, në vlerësimin e Kolegjit, konstatohet se në datën 17.04.2009, nga bashkëshortja e z. R. D. te ndërtuesi A. M, është kryer një transaksion bankar në vlerë 2,2 milionë lekë, dhe gjithashtu rezulton se po atë ditë janë tërhequr nga llogaritë e z. R. D. shumat e gjendura në llogaritë e tij, me përshkrimin *për blerje apartamenti*, në shumën prej 32.000 eurosh dhe 500.000 lekësh, të cilat në total janë në shumën 52.563 euro. Sipas këtyre të dhënave, Kolegji çmon se provohet që në këtë datë është kryer pagesa për blerjen në të ardhmen e apartamentit nga vëllai i subjektit të rivlerësimit.

Ndërsa konkludohet për pagimin e këtyre shumave që korrespondojnë me vlerën e 52.563 eurove, si një vlerë pjesore për porositjen/blerjen e apartamentit, nuk arrihet në të njëjtin përfundim për sa i përket pretendimit të subjektit se shuma prej 42.563 eurosh është kthyer prej ndërtuesit A. M te vëllai i subjektit, i cili më pas nga ana e tij i ka dhënë prej kësaj shume subjektit vlerën prej 30.000 eurosh, si hua në vitin 2013, pretendim i cili konsiderohet i paprovuar prej subjektit të rivlerësimit.

16.14 Së pari, Kolegji çmon të nënvizojë faktin se kalimi i shumës nga ndërtuesi M. te personi tjetër i lidhur, nuk provohet me ndonjë dokument bankar që të tregojë transaksionin nga ndërtuesi te personi tjetër i lidhur, siç është vepruar në rastin e kalimit të shumës prej 2.200.000 lekësh në vitin 2009 për porositjen/blerjen e apartamentit. Ky transaksion jo vetëm nuk gjen gjurmë në sistemin bankar, por as edhe në ndonjë lëvizje në llogaritë e personit tjetër të lidhur apo bashkëshortes së tij në këtë kohë nuk tregojnë për kryerjen e këtij veprimi financiar. Llogaritë e tyre bankare nuk rezulton të jenë modifikuar/ndryshuar në reflektim të një transaksioni të tillë për periudhën 2010-2013.

16.15 Së dyti, dokumenti shkresor që subjekti ka paraqitur për të provuar këtë veprim financiar, përveç se është një shkresë e thjeshtë e nënshkruar prej palëve, nuk jep asnjë besueshmëri për kohën e përpilimit të saj dhe as për vërtetësinë e deklarimeve që pasqyrohen në të. Kolegjit nuk i rezulton asnjë e dhënë që të tregojë se ky akt është përpiluar në kohën reale të ndodhjes së tij dhe aq më shumë të bindë për vërtetësinë e asaj që përmban.

16.16 Së treti, veprimi i pretenduar se ka ndodhur në vitin 2010, duket dhe vlerësohet i pabesueshëm për Kolegjin edhe për faktin se kushtet e vendosura në të dalin nga logjika e thjeshtë e një transaksioni apo veprimi të kësaj natyre. Sipas përmbajtjes së kësaj deklarate, ndërtuesi A. M pranon t'i kthejë mbrapsht personit tjetër të lidhur vlerën prej 42.563 eurosh, për një pasuri që vllente të paktën më shumë se 52.563 euro deri në përfundimin e procedurave për

²⁸ Diferenca e shumës 52.563 - 42.563 = 10.000 euro.

legalizimin e apartamentit, duke e lënë atë të vazhdojë të përdorë apartamentin për banim që prej vitit 2010 e në vazhdim, vetëm në këmbim të një depozitë prej 10.000 eurosh. Sipas këtij pretendimi, personi i lidhur ka vazhduar të banojë e të shfrytëzojë këtë pasuri për një periudhë 10-vjeçare për një vlerë qiraje, në rast se konsiderojmë parashikimin në deklaratë se shifra prej 10.000 eurosh do të konvertohet në një shpërblim për qiranë, në rast mosfinalizimi me sukses të procedurave të legalizimit të pasurisë, prej 1000 eurosh në vit. Kjo shifër përveç se vjen në kundërshtim me atë që vetë palët kanë parashikuar në këtë deklaratë, vlerën prej 15.000 lekësh në muaj si qira, bie në kundërshtim me çdo çmim të tregut të qirave në qytetin e Tiranës, në zonën ku ndodhet apartamenti (zona e ish-blokut), e cila njihet për çmime shumë më të larta qiraje e që nuk përafrohen me këto vlera, duke e bërë të pabesueshëm këtë version të ngjarjes të deklaruar në këtë deklaratë.

16.17 Së katërti, Kolegji vlerëson si të pabesueshëm edhe pretendimin tjetër të subjektit, sipas të cilit këtë shumë prej 30.000 eurosh, vëllai i tij ia ka dhënë hua për një periudhë që shkon deri në 26.08.2023 dhe pa interes. Në këtë këndvështrim, edhe sikur të pranohet se vërtet vëllai i subjektit mori paratë prej ndërtuesit në pritje të legalizimit të apartamentit, për blerjen e të cilit vazhdon të jetë i interesuar, për sa kohë që personi tjetër i lidhur nuk ka ndërprerë posedimin e kësaj pasurie për asnjë moment, pavarësisht problemeve me ligjshmërinë e këtij ndërtimi, duket e pabesueshme që këtë shumë, e cila ishte vlera korresponduese e një pjese të apartamentit, për likuidimin e të cilit do të duheshin edhe më shumë, vëllai t'ia japë subjektit për të zgjidhur ai një problem me strehimin e tij, me pritshmërinë që kjo shumë t'i kthehej pas 10 vitesh. Kolegji, edhe duke konsideruar marrëdhëniet e ngushta familjare e traditat e vendit tonë, e gjen të pabesueshëm këtë version të fakteve, për sa kohë duket se dhënia hua e kësaj shume mund të vërë në rrezik vetë përfitimën e pasurisë apartament banimi prej vëllait të subjektit të rivlerësimit, tek i cili ai banonte, meqenëse askush nuk duket se ka pasur një parashikim për kohën se kur mund të ndodhte legalizimi i objektit, që do të thotë se ishte i pritshëm të realizohej në çdo kohë.

16.18 Në analizë të qëndrimeve të mësipërme, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se vëllai i tij kishte mundësi të justifikonte me burime të ligjshme shumën prej 30.000 eurosh, të pretenduar si të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, qoftë për shkak të analizës financiare të kryer, qoftë për shkak të mosprovimit të rrethanave të faktit që duket se mbështesnin këtë pretendim.

16.19 Në këto kushte, Kolegji arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 30.000 lekësh prej huadhënësit R. D., është i drejtë. Duke qenë se kjo shumë ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament, Kolegji çmon se mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e saj afekton drejtpërdrejt burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament, duke e vendosur subjektin në situatën faktike të kualifikuar sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Në kuadër të analizës financiare, subjekti parashtron se nuk qëndron konstatimi i Komisionit lidhur me automjetin e blerë në vitin 2004, të cilin e ka përfshirë pa të drejtë në analizën financiare të vitit 2004. Analiza e kryer gjithashtu nuk ka konsideruar shpjegimet e subjektit se vlera e deklaruar në deklaratën periodike për automjetin përfaqëson jo vetëm çmimin e blerjes, por edhe detyrimet doganore dhe riparimet e tij.

17.1 Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, nga analiza e vendimit të Komisionit, rezulton se është konkluduar sa vijon: *Subjekti nuk ka pasur mundësi të krijimit të të ardhurave në shumën prej 100.000 lekësh, që kanë shërbyer për blerjen e automjetit në vitin 2004 në shumën*

prej 300000 lekësh, si dhe nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar gjendjen e likuiditeteve (në cash dhe në bankë) në fund të vitit 2004.

Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash 500.000 lekë në fund të vitit 2004, për shlyerjen e shumës 503.000 lekë, në shkurt të vitit 2005, shumë të cilën subjekti e ka deklaruar se përfaqëson zhdoganimin dhe rregullime të tjera të automjetit.

17.2 Në analizë të deklarimeve të subjektit për automjetin, konstatohet se në deklaratën për vitin 2003, subjekti ka deklaruar pasurinë automjet, me targë {***}, të fituar me kontratë dhurimi nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 26.08.1997. Me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 13.09.2004 subjekti i ka shitur automjetin, me targë {***}, shtetasit Dh. Z., me çmim 200.000 lekë dhe këtë vlerë e ka deklaruar si të ardhur edhe në deklaratën e vitit 2004 dhe në deklaratën *vetting*.

17.3 Në vitin 2004, me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.09.2004, subjekti ka blerë automjetin, me targë {***}, në shumën 300.000 lekë, veprim të cilin e ka deklaruar në deklaratën për vitin 2004, duke specifikuar se si burim krijimi ka shërbyer shuma prej 200.000 lekësh, e përfituar në këtë vit nga shitja e automjetit të dhuruar në vitin 2003, si dhe nga shuma prej 100.000 lekësh, e realizuar nga kursimet që ai ka pasur. Në vitin 2016, ky mjet është shitur nëpërmjet kontratës me nr. {***}, datë 25.08.2016, në vlerën 5000 euro. Sipas shpjegimeve të subjektit, mjeti është shitur në vlerën 5000 euro, pasi në momentin e blerjes, për të është shpenzuar vlera në 803.000 lekë dhe jo vetëm vlera e kontratës së blerjes, pasi mjeti në atë moment ka qenë i karamboluar dhe subjekti i është dashur të konsumojë shpenzime shtesë për ta bërë atë të përdorshëm. Në vijim të shqyrtimit të këtij pretendimi, është konstatuar se, në DPV-në për vitin 2004, vlera e automjetit tip Mercedes Benz, me targë {***}²⁹, është deklaruar në vlerën 803.000 lekë, ndërsa në kontratën e blerjes së po këtij viti, shuma pasqyrohet në vlerën 300.000 lekë.

17.4 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 21.09.2018, ka deklaruar se: "Zhdoganimi i automjetit është kryer më datë 04.02.2005, në shumën 503.000 lekë, me burim të ardhurash gjendjen *cash* në banesë, të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005 [...]". Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se: *Gabimi i parë është në deklaratën e vitit 2005, ku gabimisht është shënuar se ndodhen në banesën time 500.000 lekë cash, kur në fakt ato janë përdorur për të kryer pagesat e detyrimit doganor për automjetin, si dhe të gjitha pagesat për targimin e ri dhe taksat e tjera që, me blerjen e disa pajisjeve si goma etj., së bashku me vlerën e 300.000 lekëve të kontratës së vitit 2004, vlera e makinës së blerë është përfundimisht 803.000 lekë, e deklaruar saktë pikërisht në këtë vit.*

17.5 Sipas analizës financiare të kryer në Komision, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* prej 500.000 lekësh në vitin 2004, të cilat më pas të jenë përdorur për pagimin e zhdoganimit dhe riparimet në shkurt të vitit 2005. Kolegji, sipas analizës financiare të kryer për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, përdori të njëjtën logjikë si Komisioni, duke vendosur vlerën e blerjes së automjetit prej 300.000 lekësh dhe kursimet *cash* prej 500.000 lekësh si shpenzime të viti 2004. Për sa kohë që subjekti deklaroi se me këto kursime ai kishte kryer shpenzimet në shkurt të vitit 2005 për të zhdoganuar automjetin dhe për të bërë riparimet e tij dhe, për pasojë, ishte e pamundur që këto kursime prej 500.000 lekësh të ishin realizuar brenda një muaji, janar 2005. Në konkluzion të kësaj analize, të kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për t'i krijuar këto kursime në fund të vitit 2004, që më pas të mund t'i përdorte në

²⁹ *Automjet i cili më pas ka ndryshuar targën në {***}.*

fillim të vitit 2005. Sipas kësaj analize, mundësia e subjektit për kursime në vitin 2004, ishte vetëm në vlerën 81.750 lekë, dhe kjo shifër ishte e pamundur të përballonte shpenzimet prej 500.000 lekësh, deklaruar nga vetë subjekti se janë kryer për automjetin në shkurt të vitit 2005. Duke konsideruar edhe këtë kursim të mundshëm dhe të ardhurat e shpenzimet deri në shkurt 2005, subjekti rezulton me një diferencë negative në analizën e tij financiare prej – 418.430 lekësh³⁰.

17.6 Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, Kolegji arrin në konkluzionin se është i drejtë qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet për zhdoganimin dhe riparimin e automjetit tip Mercedes Benz, me targë fillestare {***} në vitin 2005, në vlerën 503.000 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë para kualifikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17.7 Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mundësinë e tij për të përballuar me burime të ligjshme shlyerjen e huas së deklaruar se është marrë prej shtetasit P. K., duke qenë se Komisioni kishte konkluduar se ai gjendej në mungesë të burimeve për ta shlyer atë. Edhe sipas analizës financiare të kryer në Kolegji, në lidhje me këtë situatë të analizuar në vendimin e Komisionit dhe të kundërshtuar në ankim prej subjektit, rezultoi se subjekti kishte mungesa të burimeve të ligjshme për të përballuar shlyerjen e kësteve të huas, sipas deklarimeve të bëra prej tij në deklaratat periodike të pasurisë³¹.

17.8 Pavarësisht kësaj analize, Kolegji vlerëson se konkluzionet e mësipërme rreth pamundësisë së personave të tjerë të lidhur për të krijuar me burime të ligjshme shumat e dhëna hua subjektit, në këtë rast shuma prej 5.000.000 lekë, e bën të paarsyeshëm e të pakuptimtë analizimin më pas të mundësisë së subjektit për të shlyer këto hua. Në këto kushte, pavarësisht faktit se subjekti rezultoi me pamundësi financiare për të shlyer huan sipas deklarimeve të tij, kjo e dhënë, në zbatim të parimit të objektivitetit, nuk do të konsiderohet prej Kolegjit si një shkak i cili mund të kualifikohet në këtë rast si një prej rasteve të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17.9 Në përfundim të vlerësimit të kontrollit të kriterit të pasurisë, duke vlerësuar konkluzionet e mësipërme që lidhen me pamundësinë e subjektit për të provuar burimet e ligjshme të shumave të dhëna hua atij prej personave të tjerë të lidhur, që kanë shërbyer si burim për financimin e blerjes së pasurisë apartament të ndodhur në Tiranë, si edhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të financuar shpenzimet që lidhen me automjetin, situata të kualifikuara sipas parashikimit të nenit 3, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se këto elemente përbëjnë një shkak për vendosjen e

³⁰ Në analizën e bërë nga Kolegji, ka ndryshime me analizën e bërë nga Komisioni kryesisht në zërin e shpenzimeve të jetesës, të cilat në analizën e Kolegjit janë marrë sipas korrespondencës së Kolegjit me ILDKPKI-në, si dhe diferenca të vogla në zërin e pagës së bashkëshortes së subjektit, e cila sipas vërtetimeve të bankës rezulton në masën 67.396 lekë (shifra e dhënë nga KPK prej 78.372 dhe nuk korrespondon as me vlerën e vërtetimeve të lëshuara nga institucioni që është 97.321 lekë, as me pagesat e bankës prej 67.396 lekësh). Një diferencë e vogël shfaqet dhe në zërin “interesa bankarë”, ku vlera e vendosur nga Komisioni është në masën 20.998 lekë, ndërsa ajo e konstatuar në Kolegji është në masën 17.898 lekë.

Gjithashtu, në analizën e Kolegjit, “cash” i pakësuar në vitin 2005 është sa diferenca e cash-it prej 500.000 lekësh me diferencën negative të vitit 2004 (500.000 - 418.430 = 81.750 lekë) pasi subjekti, sipas analizës së vitit 2004, nuk ka pasur mundësi për të kursyer shumën prej 500.000 lekësh për ta përdorur atë në vitin pasues, pasi analiza konsiston në shifra negative. Shuma e konsideruar në analizën e Kolegjit si kursim cash, në vitin 2004, është vetëm 81.750 lekë.

³¹ Diferenca negative në vlerën 949.894 lekë.

masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. *Shkaqe që lidhen me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale*

18. Subjekti ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit lidhur me vlerësimin e aftësive të tij profesionale, duke parashtruar fillimisht se raporti i vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) për kontrollin e aftësive profesionale është i padrejtë, pasi në të nuk janë konsideruar vlerësimet që ky organ ka bërë ndër vite, ecuria e karrierës së subjektit të rivlerësimit, moscenimi i vendimeve të tij nga shkallët e tjera të gjyqësorit, zbardhja në kohë e vendimeve etj.

18.1 Për këtë shkak ankimi, subjekti pretendon se nga Komisioni, në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, nuk janë konsideruar rezultatet e tij në një provim/testim të gjyqtarëve në vitin 1999, tek i cili subjekti është renditur në vendin e 25-të, edhe pse kishte pak kohë në detyrë; nuk janë konsideruar rezultatet e larta në studimet pasuniversitare “Master”, si dhe se në raportin e KLD-së e më pas edhe nga Komisioni, nuk janë konsideruar vlerësimet e bëra nga KLD-ja për vitet 2005-2006 dhe vitet 2007-2009. Lidhur me ushtrimin e detyrës, subjekti parashtron se Komisioni nuk ka konsideruar faktin se në 10 vite pune në gjykatën e apelit, ai ka mundur të dorëzojë vendimet e arsyetuara brenda afateve ligjore, me gjithë ngarkesën e madhe, gati në kufijtë e së pamundurës.

18.2 Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, adresuar në raportin e hartuar nga KLD-ja³² për procesin e tij të rivlerësimit, Kolegji çmon se është një pretendim i cili nuk mund të afektojë në asnjë rast vlerësimin që ka bërë Komisioni për këtë kriter. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qenë një organ kushtetues, i cili ka ushtruar funksionet e tij të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, i ndryshuar, në drejtim të kontrollit e menaxhimit të sistemit gjyqësor në vend, deri me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të cilat u dhanë fund funksioneve të këtij organi për t’ia kaluar ato një organi të ri, siç është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Veprimtaria e kryer prej KLD-së në vite dhe konkluzionet apo qëndrimet e saj në lidhje me karrierën apo vlerësimet e gjyqtarëve, nuk janë objekt verifikimi në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, proces i cili u miratua dhe hyri në fuqi, ndër të tjera, edhe për shkak se nga analiza që iu bë funksionimit të sistemit të drejtësisë në vend, u konkludua se organet e ngarkuara me kontrollin e realizimin e karrierës së magjistratëve nuk kishin ushtruar në mënyrën e duhur funksionet e tyre, duke lejuar, ndër të tjera, situatën e mosbesimit të lartë publik ndaj sistemit të drejtësisë. Për më tepër, vlerësimi apo renditja e subjektit në një testim të kryer shumë vite më parë, në vitin 1999, nuk mund të jetë një argument i cili mund të përdoret për vlerësimin aftësive të tij profesionale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, i cili në nenin 41, pika 3 e tij parashikon se periudha e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve do të shtrihet në tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës që nga koha e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në tetor të vitit 2016. Maksimalisht, në kuptim të pikës 4 të nenit 41 të ligjit, kjo periudhë mund të shtrihet deri në 1 janarin e vitit 2006, por jo më parë se kjo datë. Në këtë kontekst, këto pretendime të

³² Në ankim, subjekti, paragrafët 179 e 180, lidhur me raportin e KLD-së, parashtron:

“179. Inspektorët e ish-KLD (sot KLGj) kanë bërë një interpretim të saktë dhe analizë ligjore të mënyrës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe, me të drejtë, kanë dhënë opinionin si “I aftë” nga ana profesionale
180. Në kundërshtim të hapur me ligjin, në mënyrë të njëanshme dhe jashtëzakonishit joprofesionale, janë konkluzionet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

subjektit vlerësohen se nuk mund të shërbejnë për të cenuar konkluzionin e Komisionit në drejtim të kriterit të aftësive të tij profesionale.

18.3 Për sa i përket pretendimit se konkluzionet e KLD-së nuk mund të jenë determinuese për procesin e tij të rivlerësimit, Kolegji, në analizë të kuadrit ligjor në fuqi, por edhe të situatës faktike që lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit, konstaton se pretendimi i subjektit nuk gjendet i mbështetur nga vendimmarrja e Komisionit si në drejtim të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, por edhe në drejtim të vlerësimit të fakteve konkrete.

18.4 Në zbatim të ligjit të posaçëm të rivlerësimit nr. 84/2016, i cili në nenin 43 përcakton se kërkohet të përgatitet një raport nga organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale - në këtë rast KLD-ja - i cili i përcillet Komisionit, lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, konstatohet se KLD-ja, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka hartuar një raport të ri³³ për subjektin e rivlerësimit, sipas specifikave që kërkon ligji nr. 84/2016. Ky raport, jo domosdoshmërisht duhet të përputhet me vlerësimet periodike që ky organ mund të ketë bërë ndër vite për subjektin, për shkak të arsytimit të mësipërm, dhe diversiteti i tij në raport me vlerësimet e mëparshme, nuk ka një konsekuencë të drejtpërdrejtë mbi vendimmarrjen e Komisionit, për shkak të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit, por edhe për shkak të gamës më të gjerë të burimeve që përdor Komisioni në kryerjen e procesit të rivlerësimit, krahasuar me atë që përdorin organet e tjera në përpilimin e raporteve përshkruese në funksion të realizimit të këtij procesi.

Gjithashtu, vlen të nënvizohet roli i organeve të konsideruara si ndihmëse të procesit të rivlerësimit në raport me vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit, rol i mirëpërcaktuar në një sërë dispozitash që përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për këtë proces, si pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, e cila përcakton qartë: *[...] Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...].* Në vijim, Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, të drejtën për realizimin e procesit të rivlerësimit për subjektet e parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës ia atribuon Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Por mbështetur edhe në interpretimin pajtues që bëri Gjykata Kushtetuese për ligjin nr. 84/2016, në vendimin nr. 2/2017, paragrafi 5.7, sipas të cilit: *[...] Në lidhje me procesin e kontrollit të aftësive profesionale, vlerësimi që çdo organ i bën subjektit të rivlerësimit bazohet në të dhënat e deklaruara nga vetë subjekti. Ky vlerësim do të jetë në ndihmë të organeve të rivlerësimit, por jo detyruar për ta, pasi KPK-ja dhe KPA-ja kanë mjetet e provës në dispozicion për kryerjen e hetimit administrativ [...]. Në të gjitha rastet, vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit merret nga KPK-ja, bazuar në rezultatet e testimi dhe aktet e administruara në dosje.*

18.5 Bazuar në sa më sipër, as Komisioni dhe as Kolegji nuk janë të detyruar që në përfundim të procesit të rivlerësimit të kryer për subjekte prej tyre, të ndjekin apo të kenë qëndrime e konkluzione të njëjta me KLD-në, pasi ata janë të autorizuar nga Kushtetuta dhe ligji të bëjnë hetime për të kryer një proces rivlerësimi të pavarur e të pandikuar nga konkluzionet e institucioneve ndihmëse. Në rastin objekt gjykimi, ka rezultuar se përgjithësisht konstatimet e raportit përshkrues të KLD-së, në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në

³³ Për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj, KLD-ja ka hartuar raportin nr. {***}, datë 16.04.2018. Në vendimin e Komisionit, për këtë raport të KLD-së, të hartuar për procesin e rivlerësimit, për subjektin Hysni Demiraj është thënë se KLD-ja, pasi ka evidentaur disa të meta për subjektin e rivlerësimit, duke i përmendur dhe analizaur ato rast pas rasti, ka vlerësuar se subjekti ka tregaur aftësi profesionale, organizative, etike dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

analizën e tri dokumenteve të dorëzuara prej subjektit dhe pesë dosjeve të përzgjedhura nëpërmjet një sistemi rastësor, të subjektit janë gjetur pothuaj të njëjta edhe nga vlerësimi që Komisioni u ka bërë këtyre gjetjeve, por ajo që konstatohet nga analiza e tyre, është se ato nuk kanë shërbyer si një bazë e mjaftueshme për vlerësimin negativ të këtij kriteri. Për këto arsye, Kolegji, pavarësisht se në disa prej tyre nuk ndan të njëjtin qëndrim si ai i mbajtur nga Komisioni, duke qenë se vendimmarrja nuk është e përcaktuar prej tyre, por për shkaqe të tjera, do të fokusohet në trajtimin e atyre shkaqeve që duket se kanë prodhuar qëndrimin e Komisionit në drejtim të vlerësimit të këtij kriteri, por edhe qëndrimin e Kolegjit si pasojë.

19. Në ankim, subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë gjykimit të çështjes me palë të paditur M. dhe V. D., duke pretenduar se ai nuk është i argumentuar dhe i bazuar ligjërisht.

19.1 Lidhur me këtë çështje, referuar vendimit të Komisionit, ka rezultuar sa vijon. Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupës gjyquese e cila me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 08.02.2013, ka ndryshuar vendimin nr. {***}, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar kërkesë padinë e paditësit M. Ll. kundër të paditurve V. e M. D., për t'i kthyer bashkërisht paditësit shumë prej 14.700 USD.

19.2 Në analizë të këtij vendimi, si dhe duke konsideruar marrëdhënien e sipërmarrjes së subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit dhe garazhit me kompaninë “{***}”, me administratore të tij V. D., Komisioni ka konkluduar se:

- i. *Në analizë të parashtrimeve, Komisioni vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar duke qenë në konflikt të hapur interesi, përforcuar kjo me faktin se ai ka qenë ende debitor në shlyerjen e plotë të pasurisë së tij, apartament dhe garazh, ndaj njëjës prej palëve të paditura, shtetasve D..*
- ii. *Gjithashtu, pala paditëse duke qenë e panjohur me marrëdhënien kontraktuale mes palës së paditur dhe subjektit të rivlerësimit, ka qenë në kushtet e pamundësisë për të kërkuar përjashtimin e tij. Nga ana tjetër, pala e paditur e cila ka pasur marrëdhënien kontraktuale me subjektin e rivlerësimit për porosi/shitblerje pasurie, ka qenë jo vetëm e interesuar për praninë e tij në trupën gjyquese, por edhe ka përfituar nëpërmjet vendimmarrjes, e cila ka qenë e ndryshme nga ajo e dhënë në shkallë të parë. Në kushte të tilla, i vetmi person i cili do të duhej të tërhiqej nga procesi gjyqësor, për shkaqet e lartpërmendura, me sjelljen e tij të deklaronte konfliktin e interesit, ishte subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka kaluar në heshtje këtë situatë duke përfituar nga padijenja e palës paditëse. Komisioni ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se subjekti në formalizmin e kontratës për blerjet e pasurisë, ka përfituar pasurinë garazh në sipërfaqe më të madhe, si dhe me çmim preferencial.*
- iii. *Në këtë këndvështrim interpretimi i dispozitave ligjore reflekton dukshëm situatën e konfliktit të interesit.*

19.3 Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, parashtron se në gjykimin e çështjes me palë të paditur V. e M. D., për të cilin është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 08.02.2013, tek i cili subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjyqësor, çmon se ai nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e saj në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2015, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”). Subjekti ka pretenduar se rrethana faktike e prezantuar nga Komisioni nuk duhej konsideruar se ai ndodhej para zbatimit të nenit 72, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se marrëdhënien e tij të sipërmarrjes ai e ka me kompaninë {***}ShPK dhe jo me të

paditurit V. e M. D. dhe për këtë arsye nuk ndodhet në kushtet e përcaktuara nga nenit 72, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu subjekti ka parashtruar se për këtë çështje është shprehur Gjykata e Lartë dhe zgjidhja e saj nuk mund të diskutohet. Ndërkohë që për këtë çështje, në kundërshtim të hapur me ligjin, Komisioni nuk ka marrë mendimin e organit kompetent, ILDKPKI-së, në lidhje me konfliktin e interesit.

19.4 Në lidhje me këtë shkak ankimi, Kolegji, në analizë të të gjitha të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, konstaton se gjatë hetimit Komisioni ka administruar dokumentin “Gjetje” nr. {***} prot., datë 18.01.2019³⁴, i hartuar nga vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), i ngarkuar për ndjekjen e kësaj çështjeje. Në këtë dokument, vëzhguesi i bën me dije Komisionit se nga hetimi administrativ i kryer, është konstatuar se subjekti, më datë 08.02.2013, ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen që u përket shtetasve M. e V. D., duke dhënë një vendim në favor të tyre. Në këtë dokument, vëzhguesi parashtron si gjetje faktin se 4 muaj pas dhënies së këtij vendimi subjekti ka përfutur uljen e çmimit për blerjen e garazhit pa arsye të qartë dhe të bazuar, e cila mund të çojë drejt arsytimit se kemi të bëjmë me konflikt interesi. Bashkëlidhur gjetjes, vëzhguesi ka paraqitur si provë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 08.02.2013. Nisur nga kjo provë, në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar në kuptim të ligjit të zbatueshëm situatën e provuar se ka ndodhur me anë të gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar.

19.5 Lidhur me pretendimin e subjektit se për këtë çështje nuk është marrë mendimi i ILDKPKI-së, si organi kompetent për t’u shprehur mbi konfliktin e interesit, përveçse është një pretendim që synon shqyrtimin e këtij rasti vetëm në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, Kolegji e gjen atë edhe në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, i cili qartazi në dispozitat e tij dhe konkretisht në nenin 4 parashikon se Komisioni dhe Kolegji janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit (*raporti i vlerësimit i bërë nga ILDKPKI për subjektin e rivlerësimit në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 ka konstatuar se subjekti nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit*).

19.6 Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo çështje gjyqësore është gjykuar nga Gjykata e Lartë dhe zgjidhja e dhënë prej saj nuk mund të diskutohet, Kolegji çmon të evidentojë faktin se vlerësimi i Kolegjit në këtë rast nuk ka për qëllim të shtrihet mbi korrektësinë e zgjidhjes së çështjes për të cilën është shprehur edhe Gjykata e Lartë, por një situatë konflikti interesi, e cila nuk ka qenë objekt verifikimi nga Gjykata e Lartë dhe as një çështje për të cilën është tërhequr vëmendja e palëve në proces, për pasojë analiza dhe shqyrtimi që do të bëjë Kolegji nuk mbivendoset në asnjë rast me çështjet që kanë qenë në juridiksionin gjyqësor në rastin konkret.

19.7 Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit në lidhje me këtë çështje dhe qëndrimeve të mbajtura prej Komisionit, Kolegji çmon se analiza duhet të adresohet në drejtim të ligjit të zbatueshëm dhe efektit që kjo gjetje ka në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

19.8 Sipas vlerësimit të Kolegjit, situata në të cilën subjekti është gjendur duke qenë pjesë e një trupe gjykues në të cilën njëra nga palët ka qenë V. e M. D., të cilët janë ortakë të shoqërisë “{***}”, me të cilën subjekti ka qenë në një marrëdhënie sipërmarrjeje e më pas shitblerjesh,

³⁴ E administruar si dokument në fashikullin e hetimit administrativ.

është një situatë që meritonte trajtimin si një nga rastet kur gjyqtari duhet të dorëhiqej nga qenia e anëtarit të një trupi gjykues.

19.9 Në drejtim të situatës faktike, Kolegji çmon të nënvizojë faktin se të paditurit e çështjes së gjykuar, shtetasit V. e M. D., janë bashkortakë në shoqërinë “{***}”, me të cilën subjekti i rivlerësimit ka hyrë një marrëdhënie kontraktuale e sipërmarrje që në vitin 2007 për porositjen e një apartamenti, ka vazhduar me një marrëdhënie të re në vitin 2010 për porositjen e një garazhi dhe e ka finalizuar këtë marrëdhënie me lidhjen e kontratave të shitjes për këto objekte në vitin 2013.

19.10 Në kohën që kjo marrëdhënie mes subjektit si porositës dhe të paditurve si administratorë dhe ortakë³⁵ të kompanisë që kishte marrë përsipër kryerjen e porosisë ishte në fuqi dhe vazhdonte të prodhonte pasojat e saj ligjore, zhvillohet gjykimi i çështjes në fjalë, i cili përfundohet nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 08.02.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendim i cili rezulton të ketë qenë në favor të të paditurve, duke mbështetur ankimin e kryer prej tyre ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas dhënies së këtij vendimi, rezulton se subjekti ka lidhur kontratën e blerjes së pasurisë garazh, me një çmim që nga analiza e bërë në paragrafët 14.5 e 14.6 të këtij vendimi, është konsideruar si preferencial.

19.11 Në këndvështrim të kësaj faktike, Kolegji konsideron se zgjidhja e çështjes së pretenduar nga subjekti duhet bërë në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, të cilat përcaktojnë institutin e interesit pasuror dhe gjendjen e konfliktit të interesit, si edhe kushtet dhe procedurat si një zyrtar duhet ta deklarojë dhe shmangë atë.

Sipas parashikimit të nenit 13 të ligjit nr. 9367/2005, në të cilin përcaktohet: [...] 2. *Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar*, Kolegji vëren se dispozitat që duhet të zbatohen për të përcaktuar qoftë gjendjen e konfliktit, qoftë mënyrën se si duhet zgjidhur ai, në rastet kur ekziston, për rastin konkret duhet të jenë ato të paparashikuara në Kodin e Procedurës Civile, për sa kohë që veprimtaria e zyrtarit në këtë rast, e cila duket se prodhonte një situatë konflikti interesi, lidhet me veprimtarinë gjyqësore të tij.

19.12 Në këtë kontekst, Kolegji konstaton se norma e zbatueshme për rastin konkret është neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon rastet kur një gjyqtar është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje për të shmangur rastet e një konflikti interesi. Ndryshe nga sa pretendon subjekti në ankim, Kolegji vëren se në rastin konkret, rregulli ligjor mbi të cilin duhet bërë arsyetimi e vlerësimi i situatës, është neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilës: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur [...] në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”. Në rrethanat konkrete të rastit, sipas vlerësimit të Kolegjit, subjekti ishte i detyruar, për shkak të parashikimeve ligjore, të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, duke

³⁵ Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), V. D. është administratore e shoqërisë “{***}” ShPK, e cila në këtë funksion ka zëvendësuar bashkëshortin e saj M. D.. Referuar aktit të themelimit të kompanisë “{***}” ShPK, ortakë/aksionerë të saj janë përkatësisht:

1. MANDALAY GROUP HOLDINGS CORP me 51% të aksioneve, e themeluar në Ishujt Virgin të Britanisë; dhe
2. BRAMMER VENTURES CO.LTD me 49% të aksioneve, e themeluar në Liberi, ku si ortak i vetëm figuron M. D., i cili ka blerë kuotat/aksionet e kësaj shoqërie në Liberi, më 11.03.2005, dhe më pas ka transferuar selinë e saj në Shqipëri.

qenë se marrëdhënia që ekzistonte mes tij dhe palëve ndërgjyqëse ishte një marrëdhënie në fuqi, e cila vazhdonte të prodhonte pasoja të ndërsjella mes palëve dhe që përfaqësonte një interes privat për subjektin e rivlerësimit, interes i cili mund të konsiderohej se do të ndikonte në vendimmarrjen e subjektit për palën e paditur në drejtim e funksion të maksimizimit të këtij interesi.

19.13 Kolegji vlerëson se duke mos e ekspozuar këtë situatë konflikti dhe duke mos u dorëhequr prej gjykimit të çështjes, subjekti e ka vendosur veten në kushtet e konfliktit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005, situatë e cila do të ishte e tillë, pavarësisht vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në raport me çështjen.

19.14 Ky konkluzion, i konsideruar së bashku me konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar një trajtim preferencial në kuptim të nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005, të arritur në paragrafët më lart, e çon Kolegjin në përfundimin se kjo situatë duhet trajtuar e konsideruar në raport me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 96/2016.

19.15 Në kuptim të kësaj dispozite, Kolegji çmon se me këtë sjellje, subjekti ka cenuar integritetin e paanësinë e magjistratit, duke demonstruar mosrespektim të detyrimeve që i vijnë atij si zyrtar dhe funksionar i rëndësishëm publik në dëm të funksionimit të shtetit të së drejtës e të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Ky konkluzion, në vlerësimin e Kolegjit, duhet të zërë një peshë të rëndësishme në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, jo vetëm për shkak të rëndësisë që indikatorit i integritetit dhe paanësisë ka në procesin e rivlerësimit, i cili u miratua të kryhej posaçërisht për qëllimin e rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, por edhe në këndvështrim të peshës që ka ky indikator në vlerësimin periodik që u bëhet magjistratëve, në kuptim të nenit 78 të ligjit nr. 96/2016, nga interpretimi i të cilit kuptohet qartë roli dhe pesha që ligjvënësi ka dashur t'i japë këtij treguesi.

- 20.** Kolegji shqyrtoi gjithashtu edhe pretendimin e subjektit se analiza e kryer nga Komisioni për denoncimin e shtetasit A. M. është tërësisht në kundërshtim me ligjin, e njëanshme dhe bashkëpunuese me denoncuesin.

20.1 Referuar vendimit të Komisionit, si dhe akteve të administruara në fashikull, z. A. M., i cili ka qenë gjithashtu gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit një denoncim për subjektin e rivlerësimit Hysni Demiraj, sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, tek i cili jep të dhëna mbi disa çështje gjyqësore të gjykuara nga subjekti, që sipas denoncuesit janë kryer në shkelje të ligjit, çështje që i janë nënshtruar analizës së Komisionit dhe janë bërë pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Gjatë hetimit, rezulton se Komisioni ka marrë dijeni për situatën konfliktuale mes subjektit të rivlerësimit dhe denoncuesit dhe ka trajtuar dhe verifikuar të gjitha çështjet e ngritura në denoncim, duke evidentuar problematikat që në gjykimin e Komisionit mbart çdo çështje e duke sqaruar në vendim se cili është hetimi i kryer nga Komisioni, si dhe konkluzionet e nxjerra për to. Në këtë kuptim, vendimi i Komisionit ka mjaftueshëm të dhëna/elemente, si dhe një analizë të fakteve e cila nuk është një riprodhim i denoncimit, por një analizë e të gjitha elementeve dhe rrethanave të cilat për çështjet e denoncuar nga A. M., janë konsideruar nga Komisioni në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm, për pasojë pretendimi i subjektit për njëanshmëri në trajtimin e denoncimit, nuk gjendet i bazuar.

Kolegji, përtej këtij konstatimi të përgjithshëm, mori në shqyrtim shkaqet e ngritura në ankim prej subjektit dhe që lidheshin me trajtimin e çdo çështjeje konkrete, pjesë e denoncimit e të konsideruara me shkelje sipas qëndrimit të Komisionit.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit se qëndrimi i mbajtur për vendimin nr. {***}, datë 02.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket masës së sigurisë ndaj shtetasit S. Ç., është dezinformues, keqdashës, shumë i pabazuar e i bërë me qëllimin e vetëm për të politizuar subjektin e rivlerësimit me pohime të rreme, Kolegji analizoi situatën faktike e kuadrin ligjor duke përdorur të dhënat si më poshtë.

21.1 Komisioni, në vendimin e tij lidhur me këtë çështje, ka konkluduar në të njëjtën mënyrë si arsyetimi i përdorur në vendimin nr. {***}, datë 14.09.2011, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendim i cili ka ndryshuar vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit, në të cilin ka marrë pjesë subjekti. Sipas vendimit nr. {***}, datë 02.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur ndryshimi i vendimit nr. {***}, datë 11.02.2011, të Gjykatës që Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte vendosur masën e sigurimit “arrest me burg”, me afat 30-ditor për të dyshuarin S. Ç., se kishte kryer veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga nenet 79, germa “dh”, “e”, “ë” dhe 248 i Kodit Penal, situata faktike të përfshira në ngjarjet kriminale të {***} janarit 2011.

Sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar në konkluzion (sipas vendimit të Gjykatës së Lartë) se:

- i. *Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është bërë i cenushtëm nëpërmjet ankimit të ushtruar nga prokurori i çështjes.*
- ii. *Vendimi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe, si i tillë, ai është prishur duke u lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- iii. *Gjykata e Lartë e ka cilësuar vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, rrjedhojë të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë masat e sigurimit, kushtet e kriteret për caktimin e tyre (nenet 228~231).*
- iv. *Gjykata e Lartë ka argumentuar arsyet pse duhej lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Apelit duket se i ka mëshuar themelit të çështjes, ndërsa çështja i takonte thjesht dhe vetëm caktimit të masës së sigurimit personal.*
- v. *Në raport me arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar ligjërisht të kundërtën.*

Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, sikundër ka arsyetuar Gjykata e Lartë në vendimin e saj, nuk ka mbajtur në vëmendje në vendimin e dhënë asnjë prej detyrave të lëna nga Gjykata e Shkallës së Parë, për të cilën ka vendosur edhe masën e arrestit në burg me afat.

21.2 Në lidhje me këtë shkak, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka parashtruar se:

- i) prej tij është zbatuar me përpikëri neni 228, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, që përcakton kushtet dhe kriteret e masës së sigurimit, sipas të cilit askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova;
- ii) të tre shtetasit për të cilët trupit gjykues, ku subjekti ka qenë pjesë, i kanë shfuqizuar masat e arrestit me burg me afat, rezultojnë të paimplikuar në asnjë shkelje ligji dhe nuk janë thirrur qoftë dhe si dëshmitarë për ngjarjen e {***} janarit, në përfundim të hetimeve;
- iii) ai si subjekt vlerësimi nuk ka pasur asnjë njohje apo lidhje me S. Ç., i cili nuk ka punuar asnjë ditë në Prokurorinë e Tropojës, por ka qenë shofer në ish-organin e hetuesisë;

- iv) Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm për të dyshuarit e tjerë, që ishin në të njëjtat kushte si ato të të dyshuarit S. Ç..

21.3 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se vendimmarrja e trupit gjykues ku qenë pjesë edhe subjekti, është cenuar prej vendimit të Gjykatës së Lartë, në drejtim të korrektësisë e zgjidhjes së saj, pavarësisht e Gjykata e Lartë ka përdorur në arsyetimin e saj se shkeljet lidhen me shkelje të natyrës procedurale, të cilat, konsideruar natyrën e procesit gjyqësor të zhvilluar, caktimin e masës së sigurimit, janë në thelb dispozitat që rregullojnë caktimin ose jo të një mase sigurimi, pra praktikisht zgjidhjen e çështjes. Kolegji konstaton gjithashtu se në thelb të kësaj vendimmarrje ka qëndruar vlerësimi që ka bërë trupi gjykues, në të cilin ka qenë pjesë edhe subjekti, mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova si një kusht i detyrueshëm për vendosjen e një mase të sigurimit personal, sipas parashikimit të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Ky institut i së drejtës procedurale penale qëndron në vlerësimin e Kolegjit i lidhur ngushtë me bindjen e brendshme të gjyqtarit, të krijuar nga provat e administruara, se ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale ka ndodhur dhe se personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, e ka kryer atë.

21.4 Sipas vlerësimit të Kolegjit, përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues rreth dyshimit të arsyeshëm, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magjistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kriteret që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, i cili në referencë të fundit, sipas nenit 72, pika 4 e këtij ligji, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë gjyqësore duke gjykuar korrektësinë e vendimmarrjes apo themelin e çështjes. Për pasojë, në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se shkeljet e trajtuara se janë kryer nga subjekti në gjykimin e kësaj çështje, të lidhura ngushtësisht në rastin konkret me bindjen e brendshme të magjistratit, nuk mund të shërbejnë si gjetje të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

- 22.** Lidhur me shkakun tjetër të ankimit, në të cilin subjekti parashtron se analizimi i vendimit civil nr. {***}, datë 08.04.2014, i Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket çështjes së likuidatores A. K., përveçse është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi kjo çështje është ende në gjykim në Gjykatën e Lartë, por Komisioni për këtë çështje në mënyrë të qëllimshme ka paraqitur fakte të pavërteta dhe ka bërë një analizë jologjore të provave, Kolegji arsyeton sa vijon:

22.1 Pas verifikimit të kësaj çështjeje dhe problematikave të saj nga Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, në mënyrë të përmbledhur, është konkluduar se:

- i. *[...] Ndryshe nga se e zhvendos argumentin e tij subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka argumentuar në këtë çështje faktin se trupi gjykues ku bën pjesë edhe subjekti rivlerësimit ka bërë zëvendësimin e palës ndërgjyqëse që ka ndërruar jetë, duke anashkaluar dëshminë e trashëgimisë dhe bërë zëvendësimin e trashëgimlënësit, bazuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile. [...] Komisioni çmon se deklarata e marrë pikërisht palës në gjykim (pavarësisht përfundimit të procesit gjyqësor), për të cilën edhe trajtohet shkelja e kryer, nisur nga funksioni që subjekti ushtron, krijon bindjen e një marrëdhënieje me palën gjatë dhe pas gjyqimit, fakt i cili rëndon pozitën e një funksioni të tillë.*

- ii. [...] Vendimi administrativ nr. {***}, datë 11.03.2016, i subjektit të rivlerësimit nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur dhënia e tij. Shkronja "g" e nenit 18 të ligjit nr. 9877/2008, i jep kompetenca pozicionit të kryetarit të gjykatës që të kryejë detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës [...]. Drejtimi administrativ nuk nënkupton rregullimin e trupave gjyqësore në rastet e përjashtimeve të gjyqtarëve. Këtë rregullim e kanë bërë ligjet procedurale të marra me shumicë të cilësuar, të cilat konkurrojnë mbi vendimmarrje të kësaj natyre.
- iii. Komisioni krijon dyshime të arsyeshme se, nëpërmjet këtij vendimi, marrja e cilësisë së relatorit kryesisht kur përjashtohet relatori i zgjedhur me short si dhe një anëtar, humb sigurinë e transparencës së gjykimit të një çështjeje.

22.2 Në ankim, lidhur me këtë çështje, subjekti parashtroi se Komisioni në mënyrë të qëllimshme ka paraqitur fakte të pavërteta dhe bën një analizë joligjore të provave. Ai ka deklaruar se nuk e ka takuar asnjëherë palën³⁶, por vetë pala, kur është vënë në dijeni nga media, ka përcjellë pranë gjykatës, nëpërmjet sekretares gjyqësore të njohur prej tij, deklaratën noteriale në të cilën pohon se nuk ka pasur ankim nga familja e tij për vendimin e gjykatës së faktit dhe të apelit, pra nuk kanë pasur interes në zgjidhjen e çështjes. Subjekti ka parashtuar se ndryshe nga sa parashtroi vendimi i Komisionit, duke mos ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit si trashëgimlënësi V. K., ashtu edhe trashëgimtarët e tij, ata nuk janë gjykuar nga kjo gjykatë. Në këto kushte, sipas subjektit, qëndrimi i Komisionit është i pabazuar, keqdashës dhe, për më tepër, “nën efektin surprizë” të vendimit të padebatuar fare në seancë.

22.3 Nga të dhënat e akteve të administruara në fashikull, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krushë, me vendimin nr. {***}, datë 09.10.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit Vullnet Kau për shkarkimin e likuidatores A. K. nga drejtimi i procesit të likuidimit të shoqërisë “{***}” ShPK, gjykim i zhvilluar edhe ndaj personit të tretë, administratorit të shoqërisë, z. L.G.. Ndaj këtij vendimi, personi i tretë, z. L. G. dhe likuidatorja e shoqërisë, znj. A. K., kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit, ka rezultuar se kërkuari V. K. kishte ndërruar jetë dhe gjykimi është ndërprerë për t’i dhënë mundësi përfaqësuesit të kësaj pale të pajisej me dëshminë e trashëgimisë, akt që do të përcaktonte trashëgimtarët e kërkuarit, të cilët do të thirreshin në gjykim për të zëvendësuar të ndjerin. Pas këtij vendimi të trupës, të marrë në seancën e datës 19.07.2013, në seancën vijuese likuidatorja e shoqërisë ka kërkuar përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, gjyqtarëve Z. S. e V. H., kërkesë e cila është pranuar nga një trup tjetër gjykues, veprim i cili është shoqëruar me zëvendësimin e këtyre gjyqtarëve me gjyqtarët M. S. e Gj. Gj., ndërsa subjekti i rivlerësimit ka marrë në këtë trupë gjyqësore rolin e gjyqtarit kryesues/relator nga roli i anëtarit që kishte.

22.4 Në procesin gjyqësor të zhvilluar në vijim, konstatohet se ndonëse është ndërprerë gjykimi për të dhënë mundësinë e nxjerrjes së dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimtarët e kërkuarit Vullnet Kau, gjykata ka proceduar më pas nëpërmjet verifikimit që ajo vetë u ka bërë certifikatave të gjendjes civile që lidheshin me trashëgimlënësin e pjesëtarët e familjes së tij, duke përcaktuar vetë trupi gjykues se cilët janë trashëgimtarët që duhet të thirren në gjykim, për të zëvendësuar palën që kishte ndërruar jetë, në kuptim të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile. Edhe pas kryerjes së këtij veprimi, në mungesë të aktit që do të përcaktonte trashëgimtarët e trashëgimlënësit, në procesverbalin e seancës gjyqësore dhe në vendimin e nxjerrë nga gjykata në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, janë konstatuar mangësi e të meta

³⁶ E. K., pjesëmarrës në procesin gjyqësor, i cili ka paraqitur pranë Komisionit deklaratën noteriale, datë 04.02.2019, në të cilën deklarohet se ndaj vendimit të lartpërmendur nuk është ushtruar ankim, se palët kanë zgjidhur konfliktin me pajtim dhe se nuk kanë qenë të interesuar për pjesëmarrje në gjykim.

në lidhje me saktësimin e palëve ndërgjyqëse e pozicionin e tyre në proces, si për shembull përmendja në vendim e procesverbal me cilësinë e palës ndërgjyqëse, të personit të ndjerë V. K..

22.5 Kolegji analizoi këto gjetje të konstatuara prej Komisionit e të konsideruara si shkelje të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të zbatimit të ligjit procedural në rrethanat e përshkruara. Së pari, Kolegji vlerëson se kalimi procedural i një pale që ndërron jetë te trashëgimtarët e saj, është një veprim i domosdoshëm për t'u kryer nga trupi gjykues kur kjo ngjarje ndodh gjatë gjykimit të çështjes, në zbatim të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër, në këndvështrim të kuadrit ligjor në fuqi, akti që përcakton rrethin e trashëgimtarëve pas çeljes së trashëgimisë, është dëshmia e trashëgimisë e cila, në zbatim të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për noterinë", i ndryshuar³⁷, përpilohet nga noteri i cili para se të lëshojë këtë akt, detyrohet të bëjë disa veprime verifikuese e kontrolluese, siç është kontrolli i regjistrit kombëtar të testamenteve. Në këtë kuptim, që gjykata të kryejë kalimin procedural në rastet e ndërrimit të jetës së një prej palëve në proces, ajo duhet të administrojë aktin që përcakton se cilët persona duhen thirrur me këtë cilësi dhe nëse këta persona ushtrojnë ose jo efektivisht të drejtat e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit. Mungesa e këtij akti, ndonëse në rastin konkret nuk duket se ka prodhuar ndonjë pasojë, pasi trashëgimtarët e kërkuesit do të ishin po ata, në pikëpamje të zbatimit të ligjit procedural e ligjit të posaçëm që përcakton organin publik që deklaron rrethin e trashëgimtarëve e të drejtave të tyre, konsiderohet prej Kolegjit se është një defekt që demonstroi nënvleftësim të normave procedurale të detyrueshme për zbatim e mosqartësi në përcaktimin e palëve ndërgjyqëse në një proces gjyqësor, si pasojë e mungesës së dokumentacionit provues që do të përcaktonte edhe legjitimitetin e tyre në këtë kontekst.

22.6 Gjithashtu, Kolegji vëren se edhe mangësitë në paraqitjen e procesverbalit të seancës gjyqësore, të prezencës së palëve, apo gabimet në vendimin e arsyetuar të nxjerrë nga gjykata, në të cilin figuron si palë ndërgjyqëse personi që ka ndërruar jetë, ndërkohë që sipas procesverbaleve është kryer kalimi procedural nga ai te trashëgimtarët, tregon për mungesë të aftësisë e vëmendjes për të ndërtuar një strukturë të qëndrueshme, të kuptueshme të vendimit.

22.7 Për sa i përket angazhimit të palës ndërgjyqëse që me anë të një deklaratë të shpjegojë dakordësinë e saj me vendimmarrjen dhe mospasjen e ndonjë ankese ndaj subjektit në lidhje me këtë vendimmarrje, Kolegji ndonëse nuk gjen elemente të cilat e lidhin këtë veprim drejtpërdrejt me subjektin e rivlerësimit, e sheh atë të paktën si një lëvizje të provokuar për shkak të këtij procesi, në mbrojtje të interesave të subjektit, rrethanë e cila nuk konsiderohet se është korrekte në kuptim të rregullave etike që duhet të ndjekë e zbatojë një gjyqtar, në raport me sjelljen e tij me palët ndërgjyqëse.

22.8 Lidhur me parashtrimin e subjektit se kjo çështje është trajtuar nga Komisioni në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili në pikën 2 të tij shprehet: "Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim", në vlerësimin e Kolegjit, ky parashikim nuk lidhet me statusin në tërësi të çështjes, por me ato çështje të cilat janë në proces shqyrtimi nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit dhe çështja në fjalë nuk është në këtë status, pasi subjekti ka dhënë për të një vendim përfundimtar dhe, në kuptim të dispozitave procedurale, do të kishte ndalesë të rigjykonte këtë çështje, edhe në rast se Gjykata e Lartë do të dispononte për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Në këtë mënyrë, asnjë vlerësim që organet e rivlerësimit bëjnë në këto raste, nuk afekton vendimmarrjen për këtë

³⁷ *Kompetenca e noterëve për të çelur trashëgiminë është pasqyruar edhe në ndryshimet e Kodit Civil, të bëra me ligjin nr. 131/2013, i cili ka ndryshuar nenin 336 të Kodit Civil dhe ka shtuar nenin 53/1 në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994.*

çështje, për më tepër që vlerësimi në çdo rast u referohet treguesve të kriterit të aftësive profesionale, pa marrë përsipër të gjykohet mbi korrektësinë e vendimmarrjes.

22.9 Në lidhje me konkluzionin se është i dyshimtë edhe abuzues roli i subjektit të rivlerësimit në përcaktimin e trupës së re gjyqësore, të caktuar për gjykimin e çështjes, pas pranimit të kërkesës për përjashtim të dy gjyqtarëve, Kolegji vëren se, referuar akteve të administruara në fashikull, rezulton të jetë e administruar kërkesa me shkrim e likuidatores A. K. për përjashtimin e 2 gjyqtareve dhe vendimi për pranimin e kësaj kërkesë, por nuk gjenden gjurmë të akteve që pasqyrojnë ndryshimin e trupës gjyqësore dhe përcaktimin e subjektit si kryesues/relator i kësaj trupe. Në këto kushte, Kolegji e sheh të pamundur të marrë një qëndrim në lidhje me këtë konkluzion dhe e gjen konkluzionin e Komisionit të pambështetur në prova.

23. Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit në lidhje me trajtimin që Komisioni ka bërë për çështjen e shtetasit F. Sh., për të cilin ai pretendon se analizimi, përveçse është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi kjo çështje është ende në gjykim, ka të bëjë thjesht me një “lajthitje në objekt”, e cila nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për palët.

23.1 Në lidhje me trajtimin e denoncimit të ardhur në raport me këtë çështje, i cili shpreh se subjekti i rivlerësimit merr në shqyrtim kërkesën për përjashtim të një tjetër trupi gjyqësor, por në baza korruptive, bashkë me gjyqtaret e trupit gjyqësor vazhdojnë gjykimin e themelit të çështjes, kjo në kundërshtim të hapur me ligjin dhe me procedurën që ndiqej, Komisioni ka konkluduar si më poshtë.

- i. *Komisioni në këtë rast mban në vëmendje faktin që subjekti i rivlerësimit ka nisur detyrën e kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 07.03.2016, faktin që subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit dhe jo të relatorit të çështjes, faktin që subjekti deklaron se në fashikull nuk ka kërkesë me shkrim të palës për përjashtim trupi gjyqësor; por pavarësisht kësaj*
- ii. *Komisioni konstaton se subjekti nuk paraqiti aktet (procesverbalin etj.) e tjera që provojnë rihedhjen e kësaj çështjeje në short.*

23.2 Kolegji konstaton, nga analiza që u bëhet rrethanave të faktit në lidhje me këtë çështje, që në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. {***}, datë 30.12.2014, për çështjen penale me të pandehur: F. Sh., akuzuar për veprën penale të mashtrimit, bazuar në nenin 143/2 të Kodit Penal, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit F. Sh., për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit” dhe, në bazë të nenit 143/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vite burgim”.

Mbi ankimin e të pandehurit dhe apelit kundërshtues të organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, është vënë në lëvizje Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj penal nr. 2021, datë 19.11.2015, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 30.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”.

Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore, datë 23.09.2015, rezulton se çështja fillimisht po shqyrtohej nga trupi gjyqësor i përberë nga gjyqtarët A. H., F. Q. e V. H., për të cilët rezulton se është kërkuar përjashtimi nga trupi gjyqësor, në bazë të kërkesës së avokates mbrojtëse të të pandehurit, në seancën e datës 30.09.2015. Për këtë arsye, është ndërprerë gjykimi deri në dhënien përgjigje të kësaj kërkesë, e cila do të shqyrtohej nga një trupë tjetër gjyqësore.

Në dosje është administruar procesverbali, datë 22.10.2015, ku pasqyrohet një përbërje tjetër e trupit gjyqësor, në të cilin bën pjesë si anëtar i çështjes edhe subjekti i rivlerësimit, mungesa e të

pandehurit dhe avokates së tij, por për shkak të mosformimit të trupit gjykues për mungesë të një gjyqtari, i cili është pasqyruar se ndodhej në seminar, është shtyrë seanca më datë 29.10.2015. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se kjo çështje është shqyrtuar dhe përfunduar nga trupi gjykues i përbërë nga kryesues Gj. Gj. dhe anëtarë, subjekti i rivlerësimit Hysni Demiraj dhe gjyqtari M. S., me vendimin nr. 2021, datë 19.11.2015, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 30.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Në aktet e administruara, nuk rezulton asnjë akt procedural që të pasqyrojë ndryshmin e trupit gjykues apo ndonjë vendimmarrje mbi kërkesën e avokates së të pandehurit për përjashtimin e trupit gjykues.

23.3 Për këtë çështje, në ankimin e tij, subjekti shpjegon e parashtron se: *i)* kjo çështje është shqyrtuar nga Komisioni në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës; *ii)* nga drejtuesi i gjykatës i kohës (denoncuesi) është kaluar çështja për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e trupës gjyqësore dhe i është përcjellë gjyqtarit relator, pa u dorëzuar kërkesa me shkrim për përjashtim; *iii)* trajtimi i çështjes në themel nga trupi gjykues tek i cili ka qenë pjesë subjekti i rivlerësimit në cilësinë e anëtarit, ka ardhur si pasojë e një pakujdesie nga relatori i çështjes; *iv)* kjo lajthitje “në objekt” nuk pasfsheh asnjë element korruptiv, si dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për palët, pasi i pandehuri është gjykuar nga një gjykatë e paanshme e krijuar me ligj; *v)* në rekursin e paraqitur nga pala e paditur nuk ka asnjë pretendim për këtë shkelje procedurale. Për sa i përket pretendimit që lidhet me përjashtimin nga shqyrtimi për shkak se është ende për t’u gjykuar në Gjykatën Lartë, vlen i njëjti agrumet i përdorur në paragrafin 22.8 dhe pretendimi i subjektit gjendet i pambështetur në ligj në këtë drejtim.

23.4 Në lidhje me pretendimin se dosja i është përcjellë gjyqtarit relator pa një kërkesë me shkrim të avokates së të pandehurit, Kolegji vlerëson se, në zbatim të dispozitave ligjore, nenit 19 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues mund të bëhet në seancë gjyqësore menjëherë pas legjitimitit të palëve, siç edhe ka ndodhur në çështjen konkrete. Siç rezulton nga procesverbali i seancës gjyqësore, datë 30.09.2015, avokatja ka paraqitur në këtë seancë kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, e cila ka gjetur pasqyrim në procesverbalin e seancës. Për më tepër, nga aktet e përcjella nga Gjykata e Apelit Tiranë, në funksion të hetimit administrativ, rezulton se në dosje gjendet edhe kërkesa me shkrim e avokates, që mban datën 09.10.2015, pra para seancës gjyqësore të datës 22.10.2015, në të cilën ka marrë pjesë trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, pretendimi i subjekti se trupa e re gjyqësore nuk kishte një kërkesë me shkrim që ta vinte në lëvizje vëmendjen e tyre për objektin e gjykimit nuk është i mbështetur pasi, siç u përmend më lart, rezulton se kërkesa gjendet e depozituar me shkrim në dosjen penale, por edhe e pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore pararendëse.

23.5 Për sa i përket pretendimit se shqyrtimi i themelit të çështjes nga trupa gjyqësore që duhej të shqyrtonte vetëm kërkesën për përjashtimin e trupit të mëparshëm gjykues, ka qenë vetëm një pakujdesi apo lajthitje në objekt e relatorit të çështjes, Kolegji çmon se është një pretendim që nuk nderon figurën e një gjyqtari, aq më shumë të një gjyqtari të një niveli të lartë dhe me funksione drejtuese. Përcaktimi i lëndës për gjykim dhe verifikimi i kompetencës lëndore për ta gjykuar atë, janë detyra parësore të një trupe gjyqësore që merr përsipër të gjykojë një çështje gjyqësore, sado e parëndësishme qoftë ajo. Gabimet në verifikimin e këtyre elementeve të rëndësishme e që lidhen jo vetëm me mbarëvajtjen e funksionimit të trupës gjyqësore, por mbi të gjitha me garantimin e procedurave transparente në shpërndarjen e çështjeve për gjykim, sipas parashikimit ligjor të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe përcaktimeve të vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008, “Për procedurat e ndarjes së shortit të çështjeve gjyqësore”, i

ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Fakti që subjekti i rivlerësimit, si pjesë e trupës gjyqësore, ka anashkaluar të verifikojë objektin e gjykimit për të cilin ishte thirrur në panel dhe kompetencën lëndore për ta bërë këtë, kanë demonstruar një defekt të rëndësishëm në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, veçanërisht duke konsideruar rëndësinë e çështjes objekt gjykimi, e cila shihet prej Kolegjit si një e metë minimalisht e natyrës organizative, sipas parashikimit të nenit 74, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

23.6 Lidhur me pretendimin se ky lajthim në objekt nuk ka pasur asnjë prapavijë korruptive dhe asnjë pasojë për çështjen, Kolegji çmon se pavarësisht këtij fakti, shkelja e sipërcituar ekziston dhe kualifikohet si e tillë, në kuptim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Situata e kundërt, në rast se do të vërtetoheshin rrethana të një natyre tjetër, që dilnin nga konteksti i defekteve të natyrës profesionale, do të sillte si pasojë kualifikime të tjera më të rënda për subjektin e rivlerësimit, të cilat në rastin konkret nuk rezultojnë se ekzistojnë. I njëjti argument vlen edhe në lidhje me pretendimin se palët nuk kanë pasur ankime në drejtim të kësaj shkeljeje, duke qenë se as ky fakt nuk korrekton shkeljen e kryer, e cila ka lidhje me zbatimin korrekt të ligjit dhe jo me vlerësimin e palëve ndërgjyqëse në raport me të.

- 24.** Në lidhje me çështjen e gjykuar, me palë të paditur denoncuesin B. Sh., subjekti parashtron se ka zbatuar me përpikëri ligjin dhe se gabimet materiale të vërejtura janë gabime njerëzore, pa pasoja dhe të riparueshme.

24.1 Nga verifikimi i akteve të administruara, rezulton se në lidhje me denoncimin e shtetasit B. Sh., në vendimin e Komisionit është konkluduar sa vijon.

i. [...]

ii. *Subjekti ka miratuar dorëheqjen e gjyqtareve, më datë 13.12.2017, pa pasur më parë kërkesën me shkrim të tyre.*

iii. *Subjekti ndryshe nga sa pranon, dorëheqjet e para pa kërkesë me shkrim, ka miratuar kërkesën e dy anëtarëve zëvendësues, V. H. dhe A. H. (pasi edhe për ta është kërkuar dorëheqja nga gjykimi i kësaj çështjeje), më datë 02.02.2018, vetëm pasi është depozituar prej tyre kërkesa me shkrim, më datë 30.01.2018.*

iv. *Subjekti, në rastin më sipër që i përket denoncimit për çështjen penale në ngarkim të të pandehurit F. Sh., është shprehur se: "Unë gjatë punës trevjeçare si drejtues, nuk kam kaluar asnjë çështje [...] pa kërkesën me shkrim tek asnjë gjyqtar i kësaj gjykate", ndërsa konstatohet se ka vepruar krejt ndryshe dhe, për pasojë, në kundërshtim me paragrafin e fundit të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.*

24.2 Në analizë të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni për çështjen që denoncon z. B. Sh., konstatohet se konkluzionet për këtë çështje lidhen kryesisht me procedurat që ka kryer subjekti jo si anëtar i trupës gjyqësore të kësaj çështjeje, por në funksionet e kryetarit të Gjykatës së Apelit.

24.3 Kolegji konstaton, në analizë të rrethanave të faktit, se me këtë cilësi, subjekti i rivlerësimit ka pranuar dorëheqjen e dy gjyqtareve, E. Ll. dhe E. T., nga gjykimi i çështjes civile me nr. {***} regjistri themeltar, që u përket palëve ndërgjyqëse si paditës i kundërpaditur M. Sh. dhe i paditur kundërpaditës "{***}" ShPK, B. Sh., Q. D., pa pasur të depozituar prej tyre një kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Këtë sjellje si titullar i gjykatës, subjekti nuk rezulton ta ketë kryer për pranimin e kërkesës për heqje dorë të dy gjyqtarëve të tjerë të kësaj çështjeje, të cilët rezulton të kenë depozituar kërkesën me shkrim për këtë qëllim. Kolegji vëren se pranimi i kërkesave për dorëheqje, pa administruar kërkesat me shkrim të gjyqtarëve që dorëhiqen, në përputhje me parashikimet e nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile,

në kuptim të të cilit nevojitet një kërkesë formale, e cila duhet t'i drejtohet kryetarit, pavarësisht se është kryer për llogari të ushtrimit të funksioneve drejtuese si kryetar i gjykatës, për shkak të natyrës procedurale të këtij akti, konsiderohet se kjo veprimtari nuk është një veprimtari me natyrë administrative, por me natyrë krejtësisht procedurale dhe e lidhur ngushtë me veprimtarinë gjyqësore, prandaj ajo nuk mund të mos jetë pjesë e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit dhe të konsiderohet si një defekt i lidhur me aftësitë organizative të tij, sipas parashikimeve të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

25. Në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit të aftësive profesionale të kryer nga Komisioni, subjekti ka parashtruar se nuk janë të drejta, të vërteta dhe të argumentuara, çështjet e ngritura në denoncimin e shtetasit M. B.

25.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, vërehet se Komisioni për këtë çështje nuk ka ndonjë konkluzion, por në vendim vetëm evidentohet sa është parashtruar në denoncimin e shtetasit M. B., sipas të cilit pretendohet :

- i. Kryerja e një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak se gjykimi mbi shqyrtimin e ankimit për masën e sigurisë është bërë në mungesë, pasi gjykata nuk ka njoftuar ankuesin.
- ii. Vendimi për masën e sigurisë nga gjykata e Apelit është marrë pa u verifikuar nëse kjo gjykatë kishte kompetencë tokësore.

25.2 Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji vlerëson se ai është jorelevant për shqyrtim, për sa kohë që edhe Komisioni nuk ka evidentuar ndonjë shkelje të subjektit të rivlerësimit, që është bërë pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, prandaj e sheh të panevojshëm shqyrtimin e këtij shkakut ankimi.

26. Në përfundim të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji arrin në përfundimin se me të drejtë Komisioni ka konkluduar në analizë të të gjitha shkeljeve të përshkruara më lart, që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit, se ai duhet të konsiderohet se ka shfaqur nivel të ulët të njohurive të tij ligjore dhe defekte jorastësore të aftësive organizative, të cilat, të para në raport me problematikën e konstatuar sipas treguesit të integritetit dhe paanësisë, për shkak të konfliktit të interesit dhe trajtimit preferencial, tregojnë se ka demonstruar mangësi të rëndësishme lidhur me paanësinë e tij në punën si gjyqtar, që bëjnë që subjekti të konsiderohet se ka treguar cilësi të papërshtatshme në punë në atë nivel dhe të asaj natyre që nuk mund të rikuperohen nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, duke u konsideruar për këtë shkak si i papërshtatshëm për të vazhduar detyrën, në kuptim të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, kualifikim i cili shkakton në zbatim të nenit 61, pika 4 e të njëjtit ligj, vendosjen ndaj tij të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

D. Shkaqe që lidhen me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

27. Konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit konsiderohet se është i papërshtatshëm për të vijuar detyrën pasi, ndër të tjera, ka cenuar edhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ai në ankim e kundërshton duke parashtruar se një gjë e tillë nuk rezultoi e provuar gjatë hetimit të kontrollit të aftësive profesionale. Subjekti gjithashtu parashtron se në vlerësimin nëse është cenuar besimi i publikut, Komisioni nuk duhet të konsideronte denoncimet e kolegut, pasi ato janë të padrejta, por duhet të kishte vlerësuar formimin e tij, rezultatet në teste dhe ecurinë e karrierës.

27.1 Lidhur me cenimin e besimit të publikut në konkluzionet përfundimtare të vendimit të Komisionit, është konkluduar se: *Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seance dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, si edhe nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

27.2 Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, konstatohet se të gjitha çështjet e analizuara më sipër në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe të aftësive profesionale të cilat janë konsideruar prej Komisionit dhe Kolegjit se kanë përbërë shkaqe për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për secilin kriter më vete, janë vlerësuar po ashtu se përbëjnë bazë për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti gjendet gjithashtu për të njëjtat shkaqe edhe në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që shkakton vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

27.3 Sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.

Ndërkohë neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si një shkak autonom shkarkimi, parashikon se: *Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

27.4 Cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si shkak shkarkimi, në bazë të një interpretimi sistematik, konstatohet se është renditur si shkak i fundit i shkarkimit në dispozitën që parashikon të gjitha rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimit, pikërisht neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ka në përbërje të saj çdo situatë shkeljesh ligjore të cilat, edhe nën frymën e neneve D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, përfaqësojnë shkelje të ligjit të afta për të shkaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në raport me secilin prej kriterëve të rivlerësimit. Konkretisht, neni 61, pikat 1 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e pasurisë, neni 61, pikat 2 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e figurës, dhe neni 61, pika 4 është shkak shkarkimi për kriterin e aftësive profesionale. Në vlerësimin e Kolegjit, në çdo situatë faktike që mund të lidhet me secilin prej kriterëve dhe që mund të klasifikohet në secilin prej rasteve të mësipërme, subjekti gjendet në kushtet e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në rast se shkeljet e ligjit për secilin kriter, por edhe vetëm për njërin prej tyre janë tilla, që klasifikojnë situatën sipas asaj që parashikojnë pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61, subjekti do të gjendet para vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, siç është edhe rasti objekt gjykimi, i cili me të drejtë është klasifikuar sipas parashikimit të nenit 61, pikat 3 dhe 4.

Duke përdorur arsyetimin si më sipër dhe në zbatim të parimit të mosndëshkimit dy herë për të njëjtën shkelje, Kolegji, në analizë të situatës faktike dhe parashikimeve ligjore që duhen zbatuar, arrin në konkluzionin se ky qëndrim i Komisionit, i cili kualifikon dy herë si shkak

shkarkimi, për efekt të këtij procesi, të njëjtën shkelje, nuk është i mbështetur në ligj dhe, si i tillë, nuk duhet të miratohet për këtë qëndrim.

28. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, konstaton se subjekti i rivlerësimit Hysni Demiraj gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit D dhe pika 4 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pikat 3 dhe 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 108, datë 15.02.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që e ka shkarkuar atë nga detyra, është i drejtë, i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 108, datë 15.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysni Demiraj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.07.2020

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi